



# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM 2022

Master i Shkencave në

---

**Drejtësi  
në profilet:**

**a. E Drejtë penale**

**b. E Drejtë ndërkombëtare**

2022





## KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR"

### RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" në profilet: a. E Drejtë penale; b. E Drejtë ndërkombëtare**

#### Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

- |                         |                          |
|-------------------------|--------------------------|
| 1. Dr. Nertil Bërdufi   | Kryetar                  |
| 2. Dr. Ilirjana Kaceli  | Anëtar                   |
| 3. Dr. Ada Guven        | Anëtar                   |
| 4. Msc. Fioralba Markja | Anëtar (relator)         |
| 5. Emri Selami          | Përfaqësues i studentëve |

Shkurt/2022



*Ilirjana Kaceli*

1  
*Emri Selami*

*[Handwritten signatures]*

## Tabela e përmbajtjes

A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM.....	3
B. SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË....	8
C. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM.....	10
D. VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË “DREJTËSI” NË PROFILET: A. E DREJTË PENALE; B. E DREJTË NDËRKOMBËTARE” .....	12
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE .....	12
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE .....	21
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT .....	34
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	50
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE.....	56
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE .....	66
D. PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË “DREJTËSI” NË PROFILET: A. E DREJTË PENALE; B. E DREJTË NDËRKOMBËTARE TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË “KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR” .....	72

*[Signature]*

*[Signature]*

2

*[Signature]*



*[Signature]*

## A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM

Departamenti i Drejtësisë është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Departamenti i Drejtësisë operon si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave juridike, në përputhje me ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për t’i shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit.

Programi i studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e *Drejtë Penale* dhe profili e *Drejtë Ndërkombëtare*, është projektuar t’u ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e shkencave juridike. Programi “Master i Shkencave” në Drejtësi synon t’u ofrojë mundësi studentëve të thellojnë njohuritë dhe të specializohen në fushën e së drejtës, dhe kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare, duke u njohur me nocionet juridike penale dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre dy viteve studentët do të thellojnë njohuritë e marra gjatë ciklit të mëparshëm duke synuar përgatitjen e juristëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Programi synon të nxisë studentët të thellohen në punën kërkimore, shkencore dhe angazhimin e tyre si personel akademik.

Departamenti i Drejtësisë parashtron arsim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale dhe akademike në fusha të ndryshme të së drejtës, si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat.

Departamenti ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në Drejtësi, konkretisht:

- “Bachelor” në Drejtësi
- “Program i integruar i nivelit të dytë, Master i Shkencave në Drejtësi
- “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E Drejtë Penale; b. E Drejtë Ndërkombëtare.

### Rreth programit “Master i Shkencave” në Drejtësi, në profilin: a. E Drejtë Penale

Programi “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili *E drejtë penale* përfshin fushën juridiko-penale, i cili ka për qëllim arsimimin akademik dhe trajnimin profesional të studentëve dhe të formojë njohuri specifike të pasqyruara në drejtim të zhvillimeve dhe të përmirësimit të legjislacionit penal. Ky program studimi përgatit specialistë të aftë për të organizuar, planifikuar dhe drejtuar veprime procedurale që duhet të kryhen nga subjektet e procedimit penal, gjatë veprimtarisë hetimore, gjyqësore dhe të ekzekutimit të vendimeve, të lidhura me respektimin e të drejtave të njeriut në luftën kundër krimit dhe dhënien e drejtësisë në fushën e së drejtës penale. Kjo do të ndikojë edhe në rritjen e garancive për një proces të rregullt ligjor.



## Misioni

Misioni i Departamentit të Drejtësisë është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t'u shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që u shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi.

## Vizioni

Paraqitja para studentëve të programe të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë akademike dhe profesionale në fushën e drejtësisë, duke u mbështetur në baza të etikës profesionale, për të zhvilluar mendimin kritik te studentët dhe për t'i bërë ata të kuptojnë rëndësinë e rolit të tyre në shoqëri.

## Objektivat e programit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili *E drejtë penale*

1. Përvetësimi i koncepteve bazë juridike penale dhe përdorimi i tyre me efikasitet
2. Njohja me institutet e së drejtës penale në Shqipëri dhe në Europë, si dhe dallimet që kanë sistemet e ndryshme penale ligjore
3. Familjarizimi i studentëve me përgjegjësinë etike dhe profesionale
4. Njohja me kushtet sociale, ekonomike, historike, politike dhe filozofike që kanë ndikuar në sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri, si dhe njohja e faktorëve dhe vlerave që kanë ndikuar në formësimin e së drejtës penale
5. Njohja me faktin që ligji (e drejta) bazohet në sisteme të ndryshme vlerash të cilat janë vazhdimisht në ndryshim.
6. Integrimi i teorikës, praktikës dhe politikave të ndryshme, në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të ligjit.
7. Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijes dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme në mënyrë që të jenë të aftë për tu përshtatur me tregun e punës.
8. Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin.
9. Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që t'i përshtaten tregut të punës.
10. Zhvillimi i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit, duke përfshirë këtu si organet shtetërore, ashtu edhe departamentet e tjera juridike në vend.
11. Dhënia e kontributit në zhvillimin e sistemit juridik penal në Republikën e Shqipërisë.
12. Përcjellja e trendeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës penale.
13. Përgatitje e kadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës penale në Shqipëri.

## Rezultatet e programit: “Master i Shkencave” në Drejtësi , profili *E drejtë penale*

Të diplomuarit në ciklin e dytë të studimeve, “Master i Shkencave” në Drejtësi: profili *E drejtë penale* do të jenë në gjendje:

- a) Të kuptojnë parimet fundamentale të sistemeve të drejtësisë penale dhe ndryshimet ndërmjet tyre.



- b) Të kuptojnë konceptet dhe terminologjinë ligjore nëfushën substantivë dhe procedurale të ligjit penal.
- c) Të bëjnë kërkime shkencore-juridike në fushën penale-juridike.
- d) Të angazhohen në analiza ligjore nëpërmjet rasteve të ndryshme ligjore.
- e) Të kuptojnë historikun, qëllimin, strukturën, rregullat dhe përgjegjësitë e subjekteve juridike penale.
- f) Të zhvillojnë mendimin kritik nëpërmjet leximit dhe analizimit të materialeve ligjore.
- g) Të kuptojnë ndryshimin ndërmjet së drejtës procedurale dhe asaj substanciale.
- h) Të demonstrojnë aftësi solide në parimet e së drejtës, si dhe në zbatueshmërinë e ligjit.
- i) Të kenë njohuri mbi mënyrën e investigimit të krimit dhe të pajisen me njohuri rreth raportit mjeko- ligjor, të hartuar nga institucione që merren me investigimin e krimit.
- j) Të zbatojnë ligjin me profesionalizëm dhe etikë, duke respektuar integritetin personal.
- k) Të kuptojnë ligjin si profesion publik dhe rëndësinë e ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit.
- l) Të kuptojnë klasifikimin e krimeve dhe rrezikshmërinë e tyre.
- m) Të krahasojnë ligjin penal të Shqipërisë me atë të vendeve europiane.
- n) Të kuptojnë dhe të analizojnë rolin e oficerit të policisë gjyqësore, avokatit dhe prokurorit në procesin penal.

### **Mundësitë e punësimit**

Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Drejtësisë janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik europian. Kurrikulat bashkëkohore synojnë të përgatisin:

- jurist\specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore);
- jurist\specialist në institucione ndërkombëtare;
- jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat;
- asistent avokat\asistent noter, si dhe kualifikim për pjesëmarrje në provimin e avokatisë;
- asistent kërkimor\mësimor pranë IAL-ve;
- avokat, noter;
- prokurorë, gjyqtarë.

### **Rreth programit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilin: b. E Drejtë Ndërkombëtare**

Programi “Master i shkencave” në Drejtësi, profili E drejtë ndërkombëtare ka si objektiv parësor përgatitjen e juristëve të ardhshëm, me një bagazh të gjerë në të drejtën ndërkombëtare, në mënyrë që të përmbushë nevojat e tregut të punës me individë të kualifikuar në fushën respektive. Duke pasur parasysh përpjekjet e mëdha për integrimin e Shqipërisë në strukturat perëndimore kërkesat e tregut të punës për individë të kualifikuar konsiderohen të larta.



## Misioni

Misioni i Departamentit të Drejtësisë është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t'u shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që u shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi.

## Vizioni

Paraqitja para studentëve e programeve të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë akademike dhe profesionale në fushën e drejtësisë, duke u mbështetur në baza të etikës profesionale, për të zhvilluar mendimin kritik te studentet dhe për t'i bërë ata të kuptojnë rëndësinë e rolit të tyre në shoqëri.

## Objektivat e programit të studimit "Master i shkencave" në Drejtësi: profili *E Drejtë* Ndërkombëtare:

1. Përvetësimi i koncepteve bazë juridike ndërkombëtare dhe përdorimi i tyre me efikasitet.
2. Integrimi i teorikës, praktikës dhe politikave të ndryshme në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit e ligjit ndërkombëtar.
3. Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijes dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme, në mënyrë që të jenë të aftë për tu përshtatur me tregun e punës.
4. Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin.
5. Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me tëmësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që t'i përshtaten tregut të punës.
6. Zhvillim i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit, duke përfshirë këtu si organet shtetërore, ashtu edhe departamentet e tjera juridike në vend.
7. Përcjellja e trendëve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare.
8. Përgatitje e kuadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë etj.
9. Përgatitja e kuadrove në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe europiane.

## Të diplomuarit në e ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në Drejtësi: profili e drejtë ndërkombëtare do të jenë në gjendje të:

- a) Kuptojnë konceptet dhe terminologjinë ligjore në fushën ndërkombëtare të ligjit.
- b) Demonstrjnë mundësinë që të identifikojnë dhe të kuptojnë konceptet ligjore, teoritë ligjore dhe procedurat sipas ligjit ndërkombëtar.
- c) Bëjnë kërkime shkencore juridike në fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare.
- d) Angazhohen në analiza të ndryshme ligjore të së drejtës ndërkombëtare.
- e) Zhvillojnë mendimin kritik në leximin dhe analizimin e materialeve ligjore.

6







## B. SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### I. Rekomandimet e akreditimit

- 1) Institucioni, të sigurojë përshtatje të plotë midis lëndëve të programit dhe profilit të stafit akademik që angazhohet në mësimdhënie në ato lëndë.
- 2) Institucioni, të rishikojë syllabuset me qëllim përmirësimin e kurrikulës në disa drejtime në mënyrë që të sigurohet koherenca e brendshme e syllabuseve si dhe koherenca me objektivat e programit të studimit në fjalë.
- 3) Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi, me qëllim përfshirjen e praktikës profesionale/internshipit si element i detyrueshëm kurrikular.
- 4) Institucioni, të marrë masa konkrete për përditësimin e titujve në bibliotekë me qëllim që të reflektohet debati akademik bashkëkohor si dhe të sigurojë që literatura e detyrueshme për lëndët e programit të jetë e pranishme në bibliotekë.
- 5) Institucioni, të hartojë një plan të qartë veprimi lidhur me veprimtarinë e Komisionit dhe Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe të marrë masa që aktivitetet monitoruese të kësaj njësie të jenë të mirorganizuara me qëllim përmbushjen e detyrave sikurse parashikuar në aktet rregulluese.
- 6) Institucioni, të marrë masa për inkurajimin dhe përmirësimin e rezultateve të kërkimit shkencor, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore.



### II. Plotësimi i tyre nga institucioni

- 1) Për rekomandimin e parë institucioni dhe departamenti i kanë marrë të gjitha masat që profili i stafit akademik të jetë në përshtatje të plotë me lëndën që angazhohet. Plotësimi i këtij rekomandimi mund të kontrollohet nga CV e stafit me lëndën ku janë angazhuar.
- 2) Rekomandimi i dytë është një proces i vazhdueshëm që institucioni dhe departamenti bëjnë çdo vit akademik, duke rishikuar syllabuset me qëllim përmirësimin e kurrikulës në disa drejtime në mënyrë që të sigurohet koherenca e brendshme e tyre. Për këtë arsye kurrikula e programit nga akreditimi fundit ka ndryshuar pikërisht për t'iu përshtatur objektivave të programit.
- 3) Për rekomandimin e tretë institucioni ka rishikuar kurrikulën e këtij programi studimi dhe ka përfshirë praktikën profesionale si element i detyrueshëm kurrikular, duke i caktuar 12 ECTS. Praktika profesionale është vendosur në vitin e dytë semestri i katërt.
- 4) Për rekomandimin e katërt institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në bibliotekë. Literatura, e cila gjendet në formë fizike dhe elektronike, është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e studentëve dhe stafit akademik, kjo literaturë përditësohet, zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Bedër gjithashtu vazhdon të ripërtërijë abonimin në bibliotekën online JSTOR prej vitit 2019.
- 5) Institucioni në bashkëpunim me Komisionin dhe Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka një plan të qartë veprimi, lidhur me veprimtarinë e tyre duke përfshirë dhe



masat monitoruese të kësaj njësie. Ky plan i detajuar jep një garanci më të madhe ndjekjes dhe marrjes së masave konkrete në mënyrë që të kemi ruajtje dhe përmisim të cilësisë institucionale.

- 6) Kërkimi shkencor është ndër vlerat integrale që e bën institucionin të qëndrueshëm në një kohë të gjatë. Statusi znë i veçantë na vë përpara përgjegjësisë që si një institucion arsimor të krijojmë impakt për të mirën e shoqëri përmes ekselencës, kërkimit dhe inovacionit dhe krijimit të vlerës. Në këtë kuadër ne e konsiderojmë kërkimin shkencor si forma kryesore e angazhimit me palët e interesit dhe si mënyra kryesore për të avancuar kufijtë e dijes dhe njohurive. Plani i Kërkimit Shkencor integron vlerat dhe misionin në pesë prioritete të shoqëruara me objektivat dhe strategjitë për të përmirësuar dhe përshpejtuar kërkimin shkencor të insitucionit. Këto prioritete përfshijnë: Gjetja dhe arritja e ekcelencës në kërkim; Përmirësimi i integritit të kërkimit dhe edukimit; Zgjerimi i bashkëpunimeve, inovacionit; Përmirësimi i Konkurrencës në Kërkim përmes Diferencimit dhe Specializimit; dhe Përmirësimi dhe Optimizimi në Ofrimin e Shërbimeve Kërkimore. Për të arritur këto objektiva është parashikuar dhe ka filluar të vihet në zbatim plani i implememit të strategjisë kërkimore institucionale.



## C. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutit të Kolegjit Universitar “Bedër”, si dhe urdhrin të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë”, nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë dhe me vendim të Senatit Akademik, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. *E Drejtë Penale*; b. *E Drejtë Ndërkombëtare*.<sup>1</sup>

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij 5 anëtarë sipas një strukture organizative (drejtuesi, sekretari etj.). GVB-ja përfshin edhe përfaqësues të studentëve, si dhe është ngritur duke marrë parasysh edhe shpërndarjen e detyrave të secili anëtar.

Ky proces rivlerësimi i jashtëm për programin e studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. *E Drejtë Penale*; b. *E Drejtë Ndërkombëtare* vjen pas një përvoje pozitive akreditimi të dyfishtë të programit me sukses. Jo vetëm kaq, por KUB ka ngritur që në fillimet e tij edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si njësi e përhershme për të kontrolluar dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve në këtë drejtim. Një proces tjetër me rëndësi për ruajtjen e cilësisë së brendshme ka filluar të ndiqet rregullisht nga viti 2012, ku çdo njësi bazë dhe kryesore e KUB, çdo fundviti akademik, dorëzon në Rektorat raportin vjetor, i cili në vetvete është një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë.<sup>2</sup>

Raporti i vetëvlerësimit u diskutua në njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

### ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA IAL



1. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër”.
2. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të ASCAL.
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm me propozim të Këshillit të Departamentit dhe miratim të Senatit Akademik me vendimin nr. 3, datë 26.11.2018.
4. Trajnimi i GVB nga NJSBC dhe për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
5. Kryerja e vlerësimit të brendshëm, sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it.
6. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit.

<sup>1</sup> Evidenca nr. 36 – Vendimi i Senatit Akademik mbi Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm

<sup>2</sup>Evidenca nr. 23 - Modeli i raportit vjetor i dorëzuar në Rektorat nga departamenti



7. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
8. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.



**D. VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË “DREJTËSI” NË PROFILET: A. E DREJTË PENALE; B. E DREJTË NDËRKOMBËTARE”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar Bedër (KU Bedër), si një institucion me një mision të qartë në përgatitjen e profesionistëve nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat e prioritetet kombëtare të vendit. <sup>3</sup> Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) është në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me këto interesa në asnjë element të tij. Ky program ka si synim përgatitjen e specialistëve në fushën e së drejtës penale dhe atë të së drejtës ndërkombëtare.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i Shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit të ofruara nga KU Bedër janë në përputhje të plotë me objektivin për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Programi i studimit “Master i Shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) është konceptuar si një program që mbështetet në forcimin e vlerave akademike dhe kulturore në një shoqëri në zhvillim. Respektimi i vlerave akademike dhe kulturore kombëtar përfshihet natyrshëm në këtë program studimi, duke u ofruar studentëve një formim të plotë dhe të gjithanshëm, për t’i bërë ata të gatshëm për t’u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e së drejtës penale dhe të drejtës ndërkombëtare. Kjo duket qartë me aktivitetet e shumta që ka organizuar departamenti në drejtim të ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Drejtësisë janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU Bedër dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni. <sup>4</sup> Kjo është e përcaktuar në misionin e Departamentit të Drejtësisë “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare), ku theksohet se misioni i Departamentit të Drejtësisë është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’u shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që i shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi. Objektivat e programit janë të paraqitura edhe në rregulloren e programit të studimit <sup>5</sup> dhe të pasqyruara në faqen e internetit të departamentit <law.beder.edu.al>.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programet e studimit të ofruara nga KU Bedër janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe synojnë t’i kontribuojnë nxitjes së zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Drejtësisë janë në përputhje të plotë qoftë me strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi, <sup>6</sup> ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun e

<sup>3</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4; Evidenca 03: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023.

<sup>4</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4.

<sup>5</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, neni 3.

<sup>6</sup>Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020, kapitulli I, pika 1.4; kapitulli 3, pika 3.1, B, e aksezes në internet: [https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Punesim\\_dhe\\_Aftesi\\_Plani\\_Veprimtarise](https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimtarise)



	brendshëm europian. Departamenti i Drejtësisë ka vlerësuar nevojat e tregut të punës dhe domosdoshmërinë e reformimit juridik në kuadër të reformës në drejtësi. Në këtë kuadër, bazuar në VKM, nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në tetor 2019, u rishikua kurrikula e programit. Një ndër risitë e këtij rishikimi ishte futja si lëndë e detyrueshme e praktikës mësimore.			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Që në çeljen e tij, programi “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare për arsimin e lartë, si dhe kërkesat ligjore dhe parashikimet e Kartës së Bolonjës. Politikat zhvillimore të departamentit janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Pas diplomimit, studentët mund të vazhdojnë studimet e tyre të Doktoraturës, ose studimet pasuniversitare në Shqipëri ose jashtë vendit. Ata gjithashtu mund të angazhohen në pozicionet: asistentlektorë në IAL, asistent avokat, asistent noter dhe jurist në administratë publike dhe kompani private. Pas diplomimit, studentët mund të ndjekin edhe shkollën e avokaturës.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b> Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit programi “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) është hartuar në përputhje me objektivat e zhvillimit të Kolegjit Universitar Bedër të përcaktuara qartë në planin e parë strategjik të institucionit, si dhe në planin strategjik 2018-2023. <sup>7</sup> Në planin strategjik 2018-2023 thuhet shprehimisht se Kolegji Universitar “Bedër” ka si qëllim të sigurojë një arsim cilësor, i cili bëhet garanci për studentët e diplomuar që ndihen të aftë brenda mundësive që ofron tregu i punës. Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Dokumentet kryesore ku bazohet funksionimi KU Bedër si Statuti, rregullorja themelore dhe rregullorja e organizimit akademik, përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike. <sup>8</sup> Programet e studimit të ofruara nga KU Bedër, përfshi këtu edhe programi “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij janë në përputhje me prioritetet akademike të parashikuara në dokumentet e sipërpërmendura. Neni 52 (2) i rregullores themelore parashikon se “qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë është pajisja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në fushat e specialitetit me anë të studimeve, praktikës dhe kryerjes së kërkimit shkencor në to”. Programet e studimeve të ciklit të dytë janë konceptuar si harmonizim i njohurive, duke filluar me ato bazë teorike, të fushës dhe ndihmëse dhe duke vijuar me thellime në fushat specifike.
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ashtu siç është parashikuar dhe në rregulloren e programit të studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij funksionon në përputhje të plotë me “Procesin e Bolonjës” dhe kërkesat e ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi ka të përshkruara qartë objektivat dhe kompetencat profesionale. Në rregulloren e programit, krahas objektivave janë parashikuar gjithashtu rezultatet,

<sup>7</sup>Evidenca nr. 03: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

<sup>8</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4



	organizimi i programit, mundësitë e punësimit të studentëve, gjuha e mësimdhënies dhe emërtimi i diplomës. <sup>9</sup> Programi “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij është i atashuar pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Programet e studimit të ofruara nga KU Bedër janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe synojnë t’i kontribuojnë nxitjes së zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Drejtësisë janë në përputhje të plotë qoftë me strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi, <sup>10</sup> ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun e brendshëm evropian.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.3**  
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Programi “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Programi është ndërtuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për formimin e studentëve në ciklin e dytë të studimit dhe parashikon dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që fitojnë studentët në përfundim të tij. Kuadri ligjor ku mbështetet hartimi i këtij programi përcakton standardet karakterizuese të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat karakterizojnë profilin e programit të studimit. Këto elemente janë pjesë e dosjes së programit që është aprovuar nga MASR, si dhe janë të parashikuara në rregulloren e programit të studimit. <sup>11</sup> Përmes një kurrikule të bazuar në objektiva të qartë, programi është projektuar t’u ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në këto fusha përkatëse. Programi master i shkencave në drejtësi synon t’u ofrojë mundësi studentëve të thellojnë njohuritë dhe të specializohen në fushën e së drejtës, kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare, duke u njohur me nocionet juridike penale dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre dy viteve, studentët do të thellojnë njohuritë e marra gjatë ciklit të mëparshëm, duke synuar përgatitjen e juristëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Programi synon të nxisë studentët të thellohen në punën kërkimore shkencore dhe angazhimin e tyre si staf akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të	Departamenti i Drejtësisë ka kryer studime të thelluara të tregut të punës për të parë nevojat dhe kërkesat e tregut për specialistë të së drejtës penale dhe ndërkombëtare. <sup>12</sup> Departamenti i Drejtësisë ka kryer rishikimin e kurrikulës si rezultat i akteve nënligjore (VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 - Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, e ndryshuar; Udhëzim nr.15, dt. 04.04.2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë).

<sup>9</sup> Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>10</sup> Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020, kapitulli 1, pika 1.4; kapitulli 3, pika 3.1, B, e aksesueshme në faqen web: [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Punesim\\_dhe\\_Aftesi\\_Plani\\_Veprimet.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimet.pdf)

<sup>11</sup> Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>12</sup> Evidenca nr. 86: Studimi i tregut lidhur me programet e drejtësisë



<p>studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij parashtron një strukturë të qartë të objektivave formuese, njohurive, rezultateve të të nxënit, aftësive dhe kompetencave që studenti përfiton në përfundim të ciklit 2 vjeçar. Struktura dhe përmbajtja e programit është konceptuar duke mbajtur parasysh formimin bazë të studentëve në disiplinat e përgjithshme dhe formimin specifik që garantohet nga lëndë të caktuara me objektiva të parashikuara në aftësimin praktik. Të gjithë elementët përbërës të programit të lartpërmendura janë të parashikuara dhe në formatin e syllabus të çdo lënde, i cili është i arritshëm për studentin dhe publikun përmes faqes zyrtare në internet të institucionit.<sup>13</sup> Në kurrikulën e programit të studimit është parashikuar lënda e praktikës profesionale, e cila bën të mundur gërshetimin e njohurive teorike me ato praktike duke krijuar ura lidhëse ndërmjet tregut të punës dhe institucionit, gjë e cila ndihmon në punësimin e studentëve pas diplomimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar Bedër janë në përputhje me programe të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare. Më konkretisht gjatë fazës së rishikimit të kurrikulës, grupi i punës ka shqyrtuar një sërë programesh të ngjashme në universitete europiane dhe më gjerë. Në këtë mënyrë studentët mund të përfitojnë nga mundësitë për transferimin e studimeve në universitete të tjera jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveqare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) është konceptuar në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat e BE-së dhe kuadrin e legjislativ vendas për arsimin e lartë. Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar Bedër janë hartuar në përputhje me parimet e kartës së Bolonjës, duke respektuar të gjitha kriteret e parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore vendase. Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare), ofrohet nga njësi bazë, Departamenti i Drejtësisë, e cila ka një eksperiencë 10-vjeçare në ofrimin e programit në fushën e së drejtës penale dhe së drejtës ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve është përparësi e programit Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare). Në rishikimin e kurrikulës së programit është mbajtur parasysh përfshirja e praktikës profesionale si lëndë me detyrim në semestrin e dytë të vitit të dytë. Praktika profesionale organizohet në bazë të rregullores së praktikës profesionale, e miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar Bedër.<sup>14</sup> Në këtë pikë një rol të rëndësishëm luan zyra e planifikimit të karrierës në bashkëpunim me njësinë bazë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave” duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë në drejtësi: profili e drejtë penale parashtron një arsimim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale në fushën e drejtësisë, në veçanti specializimin dhe thellimin e njohurive akademike dhe profesionale në të drejtën penale dhe të drejtën ndërkombëtare. Gjuha e mësimdhënies është në gjuhën shqipe. Por duke marrë parasysh kriteret ligjore për mbrojtjen e gjuhës angleze për tu diplomuar si dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë, leksionet mund të zhvillohen edhe në gjuhën angleze. Mësimdhënia në gjuhën angleze është kryesisht në profilin e së drejtës ndërkombëtare. Ndërkohë për nga vetë fusha e studimit (e drejta ndërkombëtare) një pjesë e literaturës që shfrytëzohet në kuadër të lëndëve të ndryshme është në gjuhën angleze. Për të arritur përthithjen e njohurive më të fundit në këtë fushë, lektorët e angazhuar në këtë program studimi, u ofrojnë studentëve</p>

<sup>13</sup>Evidenca nr. 66: Modeli i syllabuseve

<sup>14</sup>Evidenca nr. 20: Procedura mbi praktikën profesionale.





	burime të përditësuar të literaturës përmes mundësive të ofruara nga institucioni siç është biblioteka elektronike, JSTOR <sup>15</sup> .			
<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Institucioni për programin studimit “Master i shkencave”, ruan dhe arkivon dokumentacion dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze. Ky dokumentacion përfshin syllabuset, kurrikulën, raportin vjetor të departamentit, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Misioni, vizioni dhe përbërja e stafit akademik të angazhuar në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe Departamentin i Drejtësisë si njësi bazë që ofron programin e studimit Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare), demonstrojnë qartë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi. Personeli akademik i Departamentit të Drejtësisë është i përbërë nga lektorë me kohë të plotë, të cilët kanë formim të mirëfilltë akademik në fushën e së drejtës penale, së drejtës së Bashkimit Europian dhe së drejtës ndërkombëtare. <sup>16</sup> Eksperienca e personelit me kohë të plotë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe përvojat profesionale në institucione të ndryshme, japin garancinë për kapacitetet e duhura në realizimin e këtij programi studimi. <sup>17</sup> Nga ana tjetër një element i rëndësishëm është edhe angazhimi i specialistëve (gjuqtar, prokuror, jurist të së drejtës ndërkombëtare) si lektorë me kohë të pjesshme apo asistentë në lëndë të caktuara.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë si njësi bazë, i cili është pjesë e “Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë” si njësi kryesore e KU Bedër. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit dhe njësisë bazë, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Departamenti i Drejtësisë ofron gjithashtu edhe programet Bachelor në Drejtësi dhe program e integruar Master i Shkencave në Drejtësi. Oferta akademike e plotëson kuadrin e formimit në fushën e së drejtës me të gjitha disiplinat përkatëse në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) përputhet me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, e cila është përgjegjëse për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të

<sup>15</sup>Evidenca nr. 40: Marrëveshja për akses në JSTOR.

<sup>16</sup>Shtojca 1: Të dhënat përmbljedhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 7); Evidenca 52: CV-të e stafit akademik

<sup>17</sup>Shtojca 1: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabelat 6)

*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*



për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Departamenti i Drejtësisë vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e së drejtës. Kjo është e parashikuar edhe në misionin e departamentit ku theksohet se misioni i këtij departamenti është të përgatisë juristë, udhëheqës të ardhshëm të kualifikuar që kontribuojnë në avancimin e drejtësisë dhe mirëqenien e shoqërisë; të aftë të marrin pozita dhe të zënë vende pune në organet e drejtësisë, organet gjyqësore, prokurori, avokaturë, administratën shtetërore, institucionet dhe organet e ndryshme të pushtetit shtetëror dhe në sektorin privat. Departamenti angazhohet të jetë një institucion në ndjekje aktive me qëllimin e zgjidhjes së problemeve ligjore, sociale, ekonomike dhe politike, të brendshme dhe ndërkombëtare që janë me interes të veçantë për shoqërinë. Hartimi i programit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë, aktet nënligjore përkatëse, si dhe direktivave e udhëzimeve Evropiane.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Departamenti i Drejtësisë ndjek një praktikë të vazhdueshme bashkëpunimi me njësitë akademike dhe administrative për të siguruar mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit të studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare). Në fillim të çdo viti akademik, realizohet ndarja e detyrave dhe koordinimi mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë në këshillimin akademik, realizimin e koordinimit me njësitë dhe zyrat administrative dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare. <sup>18</sup> Në këtë mënyrë Këshilli i Departamentit përcakton këshilltarët akademikë për çdo grup studentësh, përfaqësuesin e departamentit në zyrën e këshillimit të karrierës dhe zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare. <sup>19</sup> Analiza kryhet përmes raportit vjetor të departamentit. <sup>20</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Në funksion të realizimit të objektivave të programeve studimore, Kolegji Universitar “Bedër” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj. KU Bedër ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve me institucionet arsimore të huaja që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare, projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale e stazhe studentore. Më konkretisht në këtë drejtim janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete në disa vende të Europës, si Rumani, Kroaci etj., që mundësojnë përfshirjen e studentëve në programe shkëmbimi. <sup>21</sup> Njëkohësisht, në kuadër të kësaj fryme bashkëpunimi, është mundësuar firmosja e memorandumëve të bashkëpunimit me zyra avokatie të ndryshme. <sup>22</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i	Departamenti i Drejtësisë për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e

<sup>18</sup>Evidenca nr. 83: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës

<sup>19</sup>Evidenca nr. 42: Vendim i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademikë; Evidenca nr. 06: Rregullore mbi Organizimin Akademik, neni 1.

<sup>20</sup>Evidenca nr. 23: Model raporti vjetor

<sup>21</sup>Evidenca nr. 34: Mobiliteti në kuadër të programit Erasmus +.

<sup>22</sup>Evidenca nr. 48: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.

17



arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	drejtë ndërkombëtare) ka nënshkruar marrëveshje me institucione të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale, të cilat u mundësojnë studentëve gërshetimin e njohurive teorike me anën praktike. <sup>23</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	KU Bedër, veçanërisht Departamenti i Drejtësisë u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale sipas programeve përkatëse. Në programin e studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare) studentët duhet të ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme me të cilat departamenti dhe institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi. <sup>2425</sup> Praktika profesionale është një lëndë me detyrim.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	KU Bedër duke u bazuar në nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm dhe trajnimet profesionale. Në këtë kuadër, zyrat përkatëse dhe departamentet ofrojnë një varg metodash dhe modulesh që synojnë zhvillimin e mëtejshëm individual dhe mosshkëputjen nga mjedisi arsimor.			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Departamenti i Drejtësisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij (e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare), vlerëson në mënyrë periodike marrëveshjet e lidhura nga institucioni me kompani dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Kërkimi shkencor, parashikuar dhe në planin strategjik të KU “Bedër”, është një ndër elementet e rëndësishme për funksionimin e aktivitetit institucional përkrah mësimdhënies dhe kontributit në shoqëri. Në këtë aspekt, rëndësi merr kërkimi shkencor, mbështetja e inovacionit, cilësia e edukimit, si dhe pranimi i studentëve cilësorë. Kërkimi shkencor ka qenë në fokus të procesit akademik në KU “Bedër”, ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. Me qëllim mbështetjen e kërkimit shkencor, pranë KU “Bedër” funksionojnë disa njësi, si qendra për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion, zyra e kërkimit shkencor, si dhe komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin. <sup>26</sup> Në mbështetje të kërkimit shkencor, funksionon edhe zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare (IRO). Rezultat i këtij bashkëpunimi janë projektet e organizuara brenda KU Bedër, si dhe një sërë projektesh dhe konferencash të përbashkëta me institucione brenda dhe jashtë vendit <sup>27</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së kërkimit shkencor, pranë KU “Bedër” është ngritur zyra e kërkimit shkencor, <sup>28</sup> e cila harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në KU “Bedër” dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të kërkimit, duke synuar të

<sup>23</sup>Evidenca nr. 48: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.

<sup>24</sup>Evidenca nr. 23: Model raporti vjetor

<sup>25</sup>Evidenca nr. 85: Shembull - Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore

<sup>26</sup>Evidenca nr. 07: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin.

<sup>27</sup>Evidenca nr. 27: Lista e konferencave shkencore

<sup>28</sup>Evidenca nr. 06: Rregullore mbi organizimin akademik



	<p>përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë ndikimin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe të komunitetit.</p> <p>Në KU “Bedër” është ngritur edhe komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e progresit të të gjitha grave dhe projekteve të kërkimit. Udhëzimi mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, në nenin 5 të tij, parashikon kriteret e shpërblimit për kërkimet dhe rezultatet në fushën e kërkimit shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Aktivitetet e ndryshme kërkimore dhe akademike në KU “Bedër” reflektohen në formate të ndryshme, si raportet vjetore, faqja zyrtare, si dhe botimet dhe librat e konferencave. Raportet vjetore të departamenteve dhe ato institucionale, si dhe faqja zyrtare e institucionit pasqyrojnë organizimin në mënyrë periodike të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të seminareve në KU “Bedër”. Këtu mund të përmenden konferencat ndërkombëtare në shkencat humane dhe konferencat ndërkombëtare në shkencat e edukimit, të cilat çdo vit kanë ardhur me një tematikë të posaçme. Konferencat janë bërë traditë 10-vjeçare e KU “Bedër”. Çdo organizim kërkimor është shoqëruar me përgatitjen e librave të konferencave, të cilat janë pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare dhe u janë dërguar të shtypura pjesëmarrësve. Ato mund të gjenden edhe në faqen e internetit të KU “Bedër”.<sup>29</sup> Gjithashtu, publikohen në mënyrë periodike dy revista shkencore, të pajisura me ISSN. Ato janë Beder Journal of Educational Sciences- BJES (ISSN 2306-0557) dhe Beder Journal of Humanities - BJH (ISSN: 2306-6083). Punimet publikohen në faqet e konferencave, botohen dhe u dërgohen elektronikisht autorëve, si dhe janë të aksesueshme në faqen e secilës revistë.</p> <p>Organizime të ngjashme janë edhe partneritetet e realizuara në rang departamenti/fakulteti me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, janë organizuar seminare, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të fushave përgjegjëse<sup>30</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>KU “Bedër” në marrëveshjen kontraktuale që nënshkruan me anëtarin e ekipit akademik, parashikon mbrojtjen e pronësisë intelektuale.<sup>31</sup> Në nenin 8 të kësaj kontrate, parashikohet e drejta e autorit dhe e pronësisë intelektuale.</p> <p>Me qëllim që personeli akademik të marrë pjesë në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit, ky i fundit përcakton edhe buxhetin. KU “Bedër” bashkëpunon me biznesin vendas dhe të huaj, si dhe merr në konsideratë faktorët ekonomikë dhe socialë. Institucioni, gjatë aktivitetit akademik, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar biznesit vendas, me të cilin janë vendosur urat e bashkëpunimit. Kërkimet shkencore, siç janë konferenca shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga KU “Bedër”, janë botuar në librat përkatës të konferencave, të pajisura me ISBN nga Biblioteka Kombëtare. KU “Bedër” mbështet iniciativat kërkimore të studentëve nëpërmjet organizimit të konferencave studentore dhe konkurseve të projekteve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Me qëllim inkurajimin e studentëve dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor, Departamenti i Drejtësisë organizon konferencën studentore në drejtësi. Në përfundim të konferencës vlerësohen me çmim tre punimet më të mira.</p> <p>Gjithashtu, KU “Bedër”, me vendim të Senatit Akademik, ka ngritur “Qendrën për Kërkuesit e Rinj”. Qendra ka për qëllim t’u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të</p>

<sup>29</sup>Linku për aksesimin e ëbsiteve të revistave shkencore, <https://ëëë.beder.edu.al/sh/content/default/revista-shkencore-8-13/8/164>

<sup>30</sup>Evidenca nr. 23: Model raporti vjetor

<sup>31</sup>Evidenca nr. 46: Model Kontrate



	institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor. KU "Bedër" fton personalitete të spikatura në fushën e drejtësisë të marrin pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura, si dhe në angazhime me kohë të pjesshme duke inkurajuar studentët dhe kërkuesit të rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE

Standardi II.1	
Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është i organizuar në 2 (dy) vite akademike, të ndara në 4 (katër) semestra. Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit 1 orë mësimore = 50 minuta. Një vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. Një semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. Format kryesore të mësimdhënies janë përgjithësisht leksione të integruara me seminare, por edhe të ndarë në leksione dhe seminare veçmas, varësisht profilit të lëndës/modulit, detyrat e kursit, ushtrimet, laboratorët, projektet, etj. Vlerësimi, sipas sistemit european të transferimit të krediteve (ECTS) nga pikëpamja akademike për leksionet/seminaret, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme, bëhet në bazë të njësisë matëse orë të zhvilluar në auditor.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga 14 lëndë, të ndara në 17 module, përfshirë edhe praktikën profesionale dhe tezën e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programit. Lëndët klasifikohen në dy lloje kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Programi, duke u mbështetur edhe në legjislacionin shqiptar mbi arsimin e lartë, studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” i përmbyll me punim diplome (tezë). Teza e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS. Teza e programit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare ka 18 kredite ECTS.<sup>32</sup></p> <p>Çdo lëndë përfshin syllabuset e veta me elementet përkatës: emërtimi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri dhe kualifikimi i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, përshkrimi, objektivat, konceptet themelore, vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit, si dhe në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet e tyre për lëndën, si dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse, duke qenë në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementeve të mësimin dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë nuk është më shumë se 20 orë në javë në auditor.</p> <p>Tabela bashkëlidhur e planit mësimor të programit tregon me detaje të gjithë elementet e tij.<sup>33</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është projektuar t’u ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e shkencave juridike. Programi Master i Shkencave në Drejtësi synon t’u ofrojë mundësi studentëve të thellojnë njohuritë dhe të specializohen në fushën e së drejtës dhe kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare, duke u njohur me nocionet juridike penale dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre dy viteve studentët do të thellojnë njohuritë e marra gjatë ciklit të mëparshëm, duke synuar përgatitjen e juristëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Programi synon të nxisë</p>

<sup>32</sup>Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

<sup>33</sup>Evidenca nr. 62: Plani mësimor sipas modelit (Tabela 10)



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>studentët të thellohen në punën kërkimore, shkencore dhe angazhimin e tyre si staf akademik.<sup>34</sup></p> <p>Si një departament i bazuar në kërkesa profesionale dhe me synimin për të përgatitur profesionistë të një shoqërie demokratike dhe të një zhvillimi bashkëkohor, përmes këtij programi synohet përbushja e misionit institucional, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të një komunikimi të qartë, që të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka profesioni i tyre në krijimin e një shoqërie të drejtë dhe në respektim të shtetit të së drejtës. Përmes një kurrikule të bazuar dhe të mbështetur në traditën e disa universiteteve perëndimore, programi synon të zhvillojë një botëkuptim të gjerë të teorive dhe të praktikës në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare.</p> <p>Përmes kombinimit të teorisë me praktikën, programi synon të përgatisë studentë me aftësi teorike dhe praktike, të gatshëm për t’u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e drejtësisë penale dhe asaj ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën penale dhe ndërkombëtare ose atë profesionale. Në përfundim të programit akademik studentët e diplomuar zhvillojnë dhe janë në gjendje: <sup>35</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojnë konceptet dhe terminologjinë ligjore në fushën ndërkombëtare të ligjit dhe atë penale;</li> <li>• Të kuptojnë parimet fundamentale të sistemeve të drejtësisë penale dhe asaj ndërkombëtare;</li> <li>• Të bëjnë kërkime shkencore juridike në fusha të ndryshme të së drejtës penale dhe ndërkombëtare;</li> <li>• Të angazhohen në analiza të ndryshme ligjore të së drejtës penale dhe ndërkombëtare;</li> <li>• Të kuptojnë ligjin si profesion publik dhe rëndësinë e ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit;</li> <li>• Të kuptojnë klasifikimin e krimeve dhe rrezikshmërinë e tyre;</li> <li>• Të krahasojnë ligjin penal të Shqipërisë me atë të vendeve europiane.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare ka rregulloren specifike të studimit. Në rregullore janë zbatuar kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Këto elemente janë të përcaktuara, si p.sh. kreditet, kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formuese dhe profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë, lëndët dhe veprimtaritë etj.<sup>36</sup></p> <p>Forma e programit të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është shqip dhe disa lëndë ofrohen edhe në gjuhën angleze, për shkak të karakterit ndërkombëtar që ato kanë. Të gjithë ata që përfundojnë me sukses studimet e ciklit të dytë në programin “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, pajisen me diplomë: “Master i shkencave” në Drejtësi në profilin E drejtë penale ose E Drejtë ndërkombëtare.</p>

<sup>34</sup>Evidenca nr. 4: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare

<sup>35</sup>Evidenca nr. 4: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare

<sup>36</sup>Evidenca nr. 4: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.



<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese janë të përcaktuara qartë në programin e ciklit të dytë “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, duke u grupuar si vijon:<sup>37</sup></p> <p>a) “Master i shkencave” në Drejtësi në profilin e drejtë penale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (A) – 6 ECTS</li> <li>- Lëndë karakterizuese (B) – 54 ECTS</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C) – 12 ECTS</li> <li>- Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS</li> <li>- Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS</li> </ul> <p>b) “Master i shkencave” në Drejtësi në profilin e drejtë ndërkombëtare</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (A) – 12 ECTS</li> <li>- Lëndë karakterizuese (B) – 60 ECTS</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C) – 18 ECTS</li> <li>- Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS</li> <li>- Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS</li> </ul> <p>Kjo ndarje respekton ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 15, datë 4.4.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Në semestrin e katërt studentët e programit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, marrin dy lëndë praktikën profesionale dhe punimin e diplomës. Lënda e praktikës profesionale ka 12 ECTS, ndërsa punimi i diplomës 18 ECTS.<sup>38</sup> Në rregulloren e programit të studimit “Master i shkencave” në Drejtësi shprehet mënyra e realizimit të diplomës, pikërisht neni 17 shprehet qartë se “Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Gjithashtu, syllabusi dhe udhëzuesi për shkrimin e punimit të diplomës janë elemente të tjera që tregojnë aspektet e aktivitetit kërkimor që realizon studentit për finalizimin e diplomës.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Standardi II.2</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>KU Bedër ka kaluar me sukses 3 akreditime institucionale, të parin në vitin 2013 nga APAAL dhe të dytin në vitin 2017 nga agjencia britanike e akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL dhe të tretin në 2021 nga ASCAL. Departamenti i Drejtësisë është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë është hapur me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nr. 286, datë 6.4.2011, si një nga njësitë kryesore të Kolegjit Universitar Bedër (KU Bedër) dhe të gjitha programet që ofron janë të akredituara. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka në përbërje të tij katër njësi bazë, ku secila prej tyre ka minimum 7 anëtarë personel akademik dhe ku minimalisht 3 prej tyre mbajnë gradën shkencore Dr., kjo në përputhje me ligjin e arsimit të lartë.<sup>39</sup></p>

<sup>37</sup>Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

<sup>38</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>39</sup>Evidenca nr. 53: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë të fakultetit (Tabelat 1)





	<p>Programi “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, programet e të cilët janë të akredituara ose në proces akreditimi brenda afateve për akreditim. Departamenti i Drejtësisë aktualisht ka të angazhuar si staf akademik me kohë të plotë: 10 persona nga të cilët 1 është me titull Prof. Dr., 5 me gradën shkencore Dr. dhe 4 me Master i Shkencave.<sup>40</sup> Nisur nga sa më sipër, rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, i përmbush detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë funksionon në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 286, datë 6.04.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (Bedër), Tiranë”, i ndryshuar, Statutin dhe rregulloren e institucionit, si edhe bazuar në aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të ligjit. Departamenti i Drejtësisë vepron si njësi bazë mësimore- kërkimore, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave të drejtësisë.</p> <p>Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit.<sup>41</sup></p> <p>Personeli i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë përbëhet nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe personeli administrativ.</p> <p>Të drejtat dhe detyrat e tyre, si dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës me të gjitha elementet përbërëse për çdo kategori personeli të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë janë parashikuar në Rregulloren Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe në rregulloret e tjera përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë që është përgjegjës për programin e studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, përbëhet nga 23 (njëzetë e tre) anëtarë të stafit akademik, nga të cilët 10 (dhjetë) me kohë të plotë dhe 13 (trembëdhjetë) me kohë të pjesshme. Në stafin me kohë të plotë 1 është me titull Prof. Dr., 5 me gradën shkencore Dr. dhe 4 me Master i shkencave.<sup>42</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e Kolegjit Universitar “Bedër”, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. Kolegjit Universitar “Bedër” është i përbërë nga dy fakultete, të cilët nga ana e tyre përbëhen nga të paktën tre njësi bazë (departamente/qendra kërkimore - shkencore). Secila njësia bazë ka në përbërje të saj minimum 7 anëtarë akademikë, ku tre prej tyre kanë gradën shkencore Dr.<sup>43</sup> Autoritetet drejtuese akademike janë Dekani dhe drejtuesit e departamenteve/qendrave. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Autoriteti kryesor administrativ është administratori i fakultetit.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë, disponojnë një strukturim organizativ në çdo shkallë të hierarkisë, duke iu përshtatur nevojave të programit të studimit dhe duke përmbushur detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Fakulteti përbëhet nga katër departamente që funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Shkencave të Komunikimit,</li> <li>• Departamenti i Drejtësisë,</li> <li>• Departamenti i Shkencave Islame, si dhe</li> <li>• Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze.</li> </ul> <p>Nga sa më sipër, njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën</p>

<sup>40</sup>Evidenca nr. 54: Numri i personelit akademik për njësinë bazë (Tabelat 2)

<sup>41</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër

<sup>42</sup>Evidenca nr. 54: Numri i personelit akademik për njësinë bazë (Tabelat 2)

<sup>43</sup>Evidenca nr. 53: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë të fakultetit (Tabelat 1)



	akademike.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. Kjo bëhet nëpërmjet caktimit të personelit ndihmës akademik për mirëmenazhimin e klinikës ligjore, sallës së gjyqit, praktikave profesionale të studentëve etj.	Departamenti i Drejtësisë angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. Kjo bëhet nëpërmjet caktimit të personelit ndihmës akademik për mirëmenazhimin e klinikës ligjore, sallës së gjyqit, praktikave profesionale të studentëve etj.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Drejtësisë, pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në nenin 10 të rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë është parashikuar se çdo program i ciklit të dytë ka një koordinatort të veçantë, i zgjedhur nga komiteti shkencor. Në mungesë të tij, ky funksion i ngarkohet përgjegjësit të departamentit. <sup>44</sup> Koordinatori i programit ka detyrat e mëposhtme: a. I propozon këshillit të departamentit planifikimet e personelit akademik, për t'imiratuar më pas Dekanati i Fakultetit dhe Senati Akademik. b. I raporton bashkërenduesit të programeve të ciklit të dytë për mbarëvajtjen e programit përkatës. c. Në bashkëpunim me udhëheqësin e kërkimit shkencor, ndjek mbarëvajtjen e punës kërkimore të studentëve të programit përkatës.			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Një ndër detyrat e koordinatort të programit është raportimi te përgjegjësi i njësive bazë mbarëvajtja e programit përkatës. Gjithashtu, krahas koordinatort një rol të rëndësishëm luan edhe këshilltari akademik në orientimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë periudhës studimore. Këshilltari akademik orienton dhe me këshillime për karrierën e studentëve pas diplomimit dhe informon vazhdimisht përgjegjësin e departamentit.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Drejtësisë pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë disponon informacionin e duhur për strukturimin e programit. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik institucional, Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë”, rregullorja e programit të studimit e deri te rregulloja e sekretarisë mësimore.” <sup>45</sup> Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të KU Bedër dhe të aksesueshme nga të gjithë. <sup>46</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është i strukturuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi i studimit përbëhet nga 14 lëndë, të ndara në 17 module, përshtirë dhe praktikën profesionale dhe tezën e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programit. Lëndët klasifikohen në dy lloje kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Programi duke u mbështetur edhe në legjislacionin shqiptar mbi arsimin e lartë, studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” i përmbyll me punim diplome (tezë). Teza e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS. Teza e programit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare ka 18 kredite ECTS. <sup>47</sup>

<sup>44</sup>Evidenca nr. 09: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

<sup>45</sup>Evidenca nr. 05: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

<sup>46</sup>Shih faqen web: [www.qac.beder.edu.al](http://www.qac.beder.edu.al)

<sup>47</sup>Evidenca nr. 62: Plani mësimor sipas modelit (Tabela 10)



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e europian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është i organizuar në lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakterizuese, lëndë me zgjedhje, njohuri të tjera formuese dhe detyrime përmblylëse, duke respektuar legjislacionin vendës në fuqi dhe Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Lëndët kanë numër kreditesh ECTS të caktuar paraprakisht, të ndara ato në mënyrë të saktë varësisht veprimtarive formuese.</p> <p>Programi është i ndarë në dy vite akademike me nga 2 semestra, ku secili semestër ka 30 kredite, në total 120 ECTS.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit.<sup>48</sup> Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në programet e lëndëve me një shpërndarje përafërsisht si më poshtë:<sup>49</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % pjesëmarrja;</li> <li>- 30-40 % testimet gjatë vitit;</li> <li>- 50-60 % provimi përfundimtar.</li> </ul> <p>Për frekuentimin e studentëve, KU Bedër ka vendosur detyrim mbi 80% për programet e ciklit të dytë të studimeve.</p> <p>Në planin mësimor janë përfshirë kreditet përkatëse për çdo lëndë apo aktivitet formues. Programi i studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare i ka të dokumentuara të gjitha syllabuset e lëndëve. Në to janë paraqitur në mënyrë të detajuar elementet përkatëse: emërtimi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri dhe kualifikimi i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit, si dhe në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportin midis tyre, format e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet e tyre për lëndën, si dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse, respektimin e Kodit të Etikës, duke qenë në përputhje me kërkesat ligjore.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregulloja e programit studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, si dhe ajo e transferimit paraqet të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, në lidhje me procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen në rast të transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të krediteve që ata kanë marrë në një program studimi.<sup>50</sup></p> <p>Në fillim të vitit akademik, gjatë fazës së orientimit, studentët informohen mbi të gjitha informacionet e nevojshme për transferimin e studimeve dhe ekuivalentimit të krediteve që ata kanë marrë në një program studimi. Këto informacione janë të publikuara në guidën e studentit, me të cilën pajiset çdo student në momentin e pranimit në KU Bedër.<sup>51</sup></p> <p>Politikat e pranimit janë të shpallura që në përfundim të vitit të mëparshëm akademik për kriteret e përgjithshme dhe specifike të regjistrimit në programet e studimit. Procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve në programin e studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, procedurat e transferimit, si dhe procedurat e ekuivalentimit të studimeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të arsimit dhe që plotëson kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit për programin e studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, miratohen nga Senati Akademik, pas propozimeve të bëra</p>

<sup>48</sup>Po aty.

<sup>49</sup>Evidenca nr. 66: Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018, (Tabela 14)

<sup>50</sup>Evidenca nr. 12: Rregullorja mbi transferimet

<sup>51</sup>Evidenca nr. 25: Guida e Studentit



	nga njësia bazë dhe ajo kryesore, brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MAS, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen në portalin U- Albania i cili është i aksesueshëm nga institucionet. Të gjitha informacionet janë të publikuara në websites e institucionit www. beder.edu.al			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për leksionet, praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara. Syllabuset për secilën lëndë janë të plota dhe të pajisura me të gjitha elementet e nevojshme:<sup>52</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pedagogu i lëndës;</li> <li>• Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit;</li> <li>• Përcaktimin e lëndës si të detyrueshme ose me zgjedhje;</li> <li>• Konceptet themelore që do të trajtohen gjatë semestrit;</li> <li>• Orët në auditor dhe si punë individuale;</li> <li>• Temat e programit mësimor të lëndës specifike;</li> <li>• Formën e kontrollit të dijeve;</li> <li>• Literaturën bazë, literaturën ndihmëse;</li> <li>• Kreditet e mundshme etj.;</li> <li>• Kërkesat/udhëzimet për respektimin e kodit të etikës.</li> </ul> <p>Të gjitha këto elemente janë në përputhje me formatet e kërkuara nga legjislati në fuqi.</p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>Programi është ndërtuar dhe bazuar në eksperiencat e universiteteve më të mira. Por, për t'u theksuar mbetet praktika që njësia bazë ndjek për rishikimin dhe përditësimin e programit dhe syllabuseve në çdo fillim viti akademik, të propozuara këto nga titullari i lëndës dhe të miratuara nga përgjegjësi i njësisë.</p> <p>Kolegji Universitar "Bedër" përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga KU Bedër dhe rregullohet përmes politikës së KU Bedër "Për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit". Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës, fakulteti, zyra e zhvillimit të kurrikulave, nën miratimin e Senatit Akademik dhe dosja e plotë arkivohet. Programi "Master i Shkencave" në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare ka pësuar disa ndryshime në lidhje me kurrikulën e tij, në përputhje me të dhënat e grumbulluara nga të diplomuarit, por edhe nga stafi akademik. Kështu, një ndryshim i tillë është përfshirja e praktikës profesionale në semestrin e 4 të programit<sup>53</sup>.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Arsimimi në programin studimit "Master i shkencave" në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislati shqiptar në fushën e arsimit të lartë, si dhe të Kartës së Bolonjës. Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe

<sup>52</sup>Evidenca nr. 39: Syllabuset e lëndëve të programit

<sup>53</sup>Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor (Tabëla 11)



	<p>nënligjore në fuqi.</p> <p>Programi i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare zgjat 2 vite akademike, të ndarë në 2 semestra për çdo vit akademik.</p> <p>Viti akademik ka 32 javë mësimore në auditor, duke përfshirë dhe javët e provimeve dhe semestri ka 16 javë mësimore në auditor.</p> <p>Programi përmban gjithsej 120 ECTS. Një vit akademik ka 60 ECTS. 1 ECTS - 25 orë mësimore punë të studentit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira të universiteteve publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit. Emërtimi, përmbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike, si dhe praktikat e ndryshme brenda dhe jashtë kurrikulare u mundëson studentëve njohuri teorike dhe praktike për kalimin sa më me lehtësi nga auditorët e kolegjit në tregun e punës.</p> <p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p> <p>Ekziston një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike. Një pjesë e konsiderueshme e programit mësimor (kurrikular dhe ekstrakurrikular) i dedikohet aftësimit praktik nëpërmjet praktikave profesionale në punë konkrete në profesion, nëpërmjet projekteve dhe detyrave të kursit me karakter tërësisht praktik. Në funksion të kësaj është edhe praktika e mirë e Departamentit të Drejtësisë, e cila vijon edhe në programin studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare për sa i përket aplikimit të praktikave profesionale në zyra avokatie, klinikën e ligjit Bedër, gjykata dhe prokurori si dhe në institucione të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Tabela e planit mësimor për programin e studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare pasqyron ndarjen e ngarkesës së veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, në komponentët mësimorë: a) mësim në auditor, si leksione, seminare, punë individuale, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; b) Punim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; c) përgatitje për provime; d) përgatitje e tezës; e) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo intershipe pranë subjekteve publike ose private.</p> <p>Në këtë plan mësimor rëndësi e veçantë i kushtohet edhe përgatitjes praktike profesionale të studentëve, nëpërmjet aplikimit të praktikave profesionale, intershipeve (kurrikulare dhe ekstrakurrikulare), detyrave dhe projekteve me karakter praktik, pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, që kanë për qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit, vëzhgimit dhe aplikimit në praktikë të koncepteve dhe teorive të mësuara në auditor me qëllim përvetësimin më të mirë të tyre nga ana e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, duke pasur parasysh dhe profilin e këtij programi. Për ta arritur këtë qëllim kurrikula ka të përfshira lëndë të tilla, si krimi kibernetik, e drejta penale europiane, e drejta e Bashkimit Europian, historia dhe teoria e së drejtës ndërkombëtare etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raportet e ndarjes midis veprimtarisë formuese të planit mësimor të programit të studimit, sipas kategorive, janë si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë (A) - Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (10%);</li> <li>• Lëndë karakterizuese (B) -Përgatitje për disiplinën shkencore (45%);</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) - Nëndisiplina, profilet dhe gruplëndë me zgjedhje (20%);</li> </ul>

*Skaceli*

*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*



tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	programit bazuar edhe në studimin e tregut. Nga të dhënat e nxjerra nga komunikimet me partnerët dhe studimi i tregut janë realizuar dhe përditësimet e kurrikulës. Mund të përmendet ndryshimi i kurrikulës ku u përfshi praktika profesionale si një lëndë e domosdoshme për afrimin e studentit më shumë me tregun e punës.			
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Programi ka pjesë të kurrikulës së tij lëndën e metodave të kërkimit, të cilat e orientojnë studentin të fitojë pavarësi dhe lirshmëri në realizimin e projekteve kërkimore- shkencore në mënyrë të pavarur dhe të suksesshme. Një aspekt tjetër ku ndërthuret aspekti i formimit teorik me atë shkencore është se në një pjesë të madhe të lëndëve të programit, provimi përfundimtar realizohet në formën e një projekti kërkimor-shkencor ku aspektet teorike ndërthuren drejtpërdrejt me ato shkencore. Gjithashtu, angazhimi i studentëve në konferenca studentore dhe aktivitete të tjera kërkimore shkencore të organizuara nga departamenti, por dhe universiteti e nxisin më tepër këtë kombinim. Kombinimi i këtyre elementeve e bëjnë studentin i cili mbaron programin “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare të aftë për t’i realizuar me sukses studimet e ciklit të tretë.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b> <b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli titullar i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është me grada dhe tituj, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. <sup>55</sup> Nga CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, vihet re se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, i angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit. Në procedurën e punësimit të stafit akademik i kushtohet shumë rëndësi përputhjes së profilit të personit që punësohet me kërkesat e programit të studimit në të cilin ai/ajo do të angazhohet.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Si personeli akademik me kohë të plotë, po ashtu edhe ai me kohë të pjesshme kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Titullarët e lëndëve janë përcaktuar kryesisht varësisht fushës së ekspertizës, gjë kjo që ndihmon në mbarëvajtjen e të gjithë procesit. Specifikisht, stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme në fushën e së drejtës, si e drejta penale, e drejta europiane etj.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit kanë grada shkencore dhe tituj akademikë. Fusha kërkimore akademike e stafit është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve. Kjo duket qartë dhe nga të dhënat e CV-ve, bashkëngjitur këtij raporti, si evidencë e stafit të angazhuar për realizimin e programit të studimit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të	Angazhimi i personelit aktual akademik synon të arrijë një punë optimale për përbushjen e objektivave të programeve të ciklit të dytë. Kjo realizohet si në

<sup>55</sup>Evidenca nr. 52: CV e stafit akademik



<p>arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. Kjo mundëson zbatimin në praktikë të aspekteve teorike të programit, të cilat sigurojnë përvetësim dhe aftësim më të plotë si nga ana e aspekteve teorike dhe praktike.</p> <p>Institucioni dhe departamenti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit dhe/ose kompani të ndryshme. Marrëveshjet realizohen nëpërmjet zyrës së marrëdhënieve me jashtë, por dhe asaj të planifikimit të karrierës, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare. Praktika profesionale, si lëndë e kurrikulës së programit, mbikëqyret bashkërisht në vendin e praktikës dhe nga anëtari i caktuar i stafit akademik të departamentit. Lënda e praktikës profesionale realizohet nga 3 lektorë (staf akademik) për çdo klasë mësimore me një ngarkesë 5-7 studentë për një lektor, i cili kryen rolin e këshilluesit dhe orientuesit, por edhe mbikëqyrësit të procesit të praktikës profesionale, në bashkëpunim me kompanitë ose institucionet përkatëse ku janë angazhuar studentët për realizimin e praktikës.<sup>56</sup></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Departamenti nuk angazhon personel ndihmësmësimor-shkencor, por asistentë lektorë të cilët ndihmojnë titullarët e lëndëve në proceset e tyre akademike. Gjatë orëve të mësimin, në varësi të nevojave specifike, pedagogët ndihmohen nga ky personel.</p> <p>Duhet të theksohet se mësimdhënia në programin “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare përgjithësisht mbështetet në leksione dhe seminare të integruara me njëra-tjetrën dhe nuk ka orë të mirëfillta laboratorike. Në ndihmë të studentëve është vënë dhe salla e gjyqit dhe klinika e ligjit të cilat përdoren për arsye praktike profesionale dhe mirëmbahet nga personeli përkatës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi II.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Politikat zhvillimore të Departamentit të Drejtësisë hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Pas hapjes së programit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare, në vitin 2011 dhe nevojave të përcaktuara varësisht kohës, për një rivlerësimin të nevojave të tregut të punës, Departamenti i Drejtësisë ka zhvilluar një studim të detajuar tregu. Studimi në fjalë përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve, numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra, numrin e kërkesave për këto programe etj. Studimi u zhvillua nga një grup pune, i ngritur brenda personelit të Departamentit të Drejtësisë, si dhe me përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> <p>Departamenti i Drejtësisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët e ndryshëm në fushën e avokatisë, noterisë, gjyqësorit dhe atë institucional, si ministria e drejtësisë dhe ajo e arsimit, me qëllim evidentimin dhe përfshirjen në programin e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.</p> <p>Në këtë kuadër janë realizuar marrëveshjebashkëpunimi me organizata dhe institucione të ndryshme homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë</p>

<sup>56</sup>Evidenca nr. 20: Procedura mbi praktikën profesionale,




	të biznesit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Në mbledhjet e Këshillit të Departamentit marrin pjesë përfaqësues të studentëve. Studentët përcjellin mendimin dhe vlerësimin e grupit mbi programin dhe lëndët specifike. Gjithashtu, pjesëmarrja aktive në anketën që realizohet për çdo lëndë në përfundim të semestrit është një mënyrë tjetër sesi studentët ndikojnë në përmirësimin e programit. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Nga ky program studimi deri më tani janë diplomuar 94 studentë të cilët në mënyrë aktive kontaktohen dhe takohen nëpërmjet departamentit, por edhe nga zyra e të diplomuarve, e ngritur pranë Dekanatit të Studentëve. Për të marrë sa më shumë propozime dhe feedback nga ata, departamenti organizon çdo vit takimet “Alumni”, si dhe realizon seminare të ndryshme përgjatë vitit akademik me të diplomuar në punë dhe studentët. <sup>57</sup> Zyra e të diplomuarve ka si përgjegjësi mbajtjen e kontakteve me të diplomuarit nga institucioni dhe zhvillimin e aktiviteteve me të diplomuarit dhe për të diplomuarit.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Bazuar në marrëveshjet që institucioni dhe departamenti ka me disa institucione private dhe publike, përfshirë bashki, universitete, zyra avokatie etj., përditëson edhe programet. Politikat zhvillimore të Departamentit të Drejtësisë hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare i ka të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të tij, të cilat janë të shprehura në rregulloren e programit. Këto objektiva dhe prioritetet janë në përputhje të plotë me objektivat strategjikë të institucionit, të përcaktuara në planin strategjik të tij. <sup>58</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Përcaktuar në Statutin e KU Bedër, por dhe në rregulloret e tjera, roli i njësive kryesore dhe asaj bazë është që të nxisë, bashkërendojë dhe administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Në këtë aspekt, njësia bazë kërkon që nga ana e stafit akademik të ketë një pjesëmarrje sa më të madhe të tyre në veprimtari akademike dhe shkencore, duke iu dhënë edhe mbështetje financiare.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nëpërmjet aktiviteteve shkencore, si konferenca, leksione të hapura, shkolla verore etj. studentët nxiten dhe motivohen për t’u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Pjesëmarrja në gjyqet imituese të Strasburgut, Hagës, Washingtonit dhe Nurembergut nga ana e departamentit gjithashtu motivon studentët e programit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare të angazhohen dhe të marrin pjesë aktive në kërkimin shkencor.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi në profilet: a. E drejtë penale; b. E drejtë ndërkombëtare fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore rajonale dhe kombëtare, ndërsa profili e drejtë ndërkombëtare fokusohet më shumë në arenën ndërkombëtare të së drejtës.
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve	Departamenti i Drejtësisë çdo vit përcakton dhe u dërgon njësive përkatëse të

<sup>57</sup> <https://www.facebook.com/270663142948338/posts/5577083395639593/?d=n>

<sup>58</sup> Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

32






studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	institucionit projektbuxhetin e tij, ku përfshin si pikë kryesore dhe mbështetjen financiare për realizimin e aktiviteteve të saj. <sup>59</sup> Nga ana tjetër institucioni në rregulloret e tij përcakton qartë dhe mbështetjen që i bëhet stafit akademik për çdo botim dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.8				
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.				
Kriteret	Vlerësimi			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni në strategjinë e tij ka si pikë thelbësore kërkimin shkencor dhe inovacionin, duke theksuar haptazi dhe mbështetjen qoftë financiare, por edhe njerëzore për realizimin e tyre. Në këtë kontekst realizimi i “WINTER SCHOOL ON COMPUTATIONAL LAW AND CYBERNETICS”, në dhjetor të vitit 2021 është një shembull pozitiv sesi institucioni mbështeti financiarisht kërkesën e paraqitur nga departamenti, si dhe ndihmoi në realizimin teknik të saj. <sup>60</sup>			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Drejtësisë angazhohet në mënyrë të plotë në lidhje me këtë pikë dhe pikërisht për realizimin e këtyre objektivave në vitin 2020 ka themeluar edhe Klinikën Ligjore e cila është e njohur dhe nga Ministria e Drejtësisë dhe realizon praktika profesionale për studentët, si dhe ndihmon njerëzit në nevojë. Po ashtu në klinikë angazhohet stafi akademik për dhënie e ndihmës dhe eksperiencës ndaj studentëve. Njëkohësisht, pjesëmarrja e stafit në programe të ndryshme si ato Erasmus+, Cost etj. janë një tjetër angazhim i njësive bazë për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime etj. <sup>61</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Departamenti organizon çdo vit akademik një konferencë studentore dhe një konferencë shkencore/workshop të cilat i ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë studentët dhe stafin për arritjen e objektivave shkencore. Gjithashtu, njësia kryesore e departamentit organizon çdo vit akademik konferenca shkencore. Në kuadër të plotësisht të objektivave, departamenti ka organizuar disa leksione të hapura “BrownBag seminars” me akademikë dhe profesionistë të fushave të ndryshme, si dhe shkolla verore dhe dimërore ku studentët e programit dhe departamentit marrin pjesë aktive.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<sup>59</sup>Evidenca nr. 28: Projektbuxheti

<sup>60</sup>Evidenca nr. 47: Shkresa e departamentit të Drejtësisë për mbështetje financiare për Winter School

<sup>61</sup>Evidenca nr. 34: Mobiliteti në kuadër të programit Erasmus +.

*(Handwritten signatures)*



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program. Rregullorja e programit përkatës është udhëzuesi i drejtpërdrejtë, në lidhje me hartimin e planeve mësimore për secilin program dhe nxitjen e përdorimit të metodave të ndryshme bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies, duke iu përshtatur fushës së studimeve që i përket kualifikimi i studentëve, llojit dhe specifikave konkrete të lëndëve, rezultateve të mundshme me vlerë të shtuar që mund të sjellin metodat e reja si rezultat në përgatitjen e lëndëve.</p> <p>KU Bedër organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit në përdorimin e metodave të ndryshme inovative në fushën e mësimdhënies, të përshtatura sipas natyrës së programeve të studimit. Për vitin akademik 2020-2021, institucioni hartoi një material udhëzues mbi metodat dhe platformat e mësimdhënies në distancë dhe realizoi trajnime online për përdorimin e platformës G-Suite për realizimin e procesit mësimor në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia e Covid-19. Këta udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit në internet.<sup>62</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Për monitorimin, vlerësimin në mënyrë periodike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)<sup>63</sup> si dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë<sup>64</sup>. Funkzionimi dhe kompetencat e NJSBC-së janë të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar "Bedër"<sup>65</sup> dhe në rregulloret përkatëse<sup>66,67</sup>. Gjithashtu, institucioni, në kuadër të vlerësimit në mënyrë periodik të aftësiave mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, realizon në fund të çdo semestri vlerësimin e lëndës dhe të pedagogut me anë të anketës së studentit për lëndën dhe pedagogun<sup>68</sup>. Anketa plotësohet nga studentët për çdo lëndë dhe pedagog, dy herë për çdo vit akademik, si dhe përbëhet nga nëntë pyetje dhe për çdo pyetje ka pesë mundësi zgjedhjeje<sup>69</sup>. Në të njëjtën kohë kryhet edhe vetëvlerësimi i pedagogut dhe vlerësimi i tij nga ana e eprorit, brenda njësisë, me anë të formularit të vetëvlerësimit<sup>70</sup>, i cili plotësohet çdo vit nga çdo pedagog. Vlerësimet e marra nga këto anketime janë objekt diskutimi me qëllim përmirësimin e lëndës në vitin pasardhës. Me përmirësimin e programit angazhohet edhe zyra e kurrikulave, e cila koordinon procesin e zhvillimit të kurrikulës, në bazë të udhëzimit përkatës për procesin e zhvillimit të kurrikulave.<sup>71</sup></p> <p>Anketa të posaçme realizohen në raste të veçanta për të kuptuar</p>

<sup>62</sup>Evidenca nr. 3: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023; Evidenca nr. 16: Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë; Mësimdhënia në distancë, i aksesueshem në faqen eeb: <https://www.beder.edu.al/sh/neës/other/mesimdhenia-ne-distance/1579>.

<sup>63</sup>Evidenca nr. 6: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

<sup>64</sup>Evidenca nr. 77: Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit

<sup>65</sup>Evidenca nr. 1: Statuti i KU "Bedër", neni 28-29

<sup>66</sup>Evidenca nr. 10: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

<sup>67</sup>Evidenca nr. 7: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit

<sup>68</sup>Evidenca nr. 29: Anketë vlerësuese për lëndën dhe pedagogun

<sup>69</sup>Evidenca nr. 11: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve

<sup>70</sup>Evidenca nr. 31: Formulari i vetëvlerësimit të stafit

<sup>71</sup>Evidenca nr. 15: Udhëzimi mbi procesin e zhvillimit të kurrikulës



	<p>problematikat e ndryshme që mund të ndodhin dhe të ndikojnë në cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ku hyjnë vështirësitë nga ana e studentëve për të ndjekur procesin mësimor për shkaqe të veçanta, forca madhore etj. Një shembull i tillë është anketa e posaçme e realizuar nga NJBSC-ja me studentët në vitin 2020, në kuadër të pandemisë Covid -19, ku synohet të kuptoheshin vështirësitë dhe problematikat e studentëve për të ndjekur procesin e mësimi online, në kushtet e karantinës me qëllim përshtatjen e këtij procesi sa më pranë nevojave të studentëve<sup>72</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet anketimit që plotësohet në fund të çdo semestri, në lidhje me vlerësimin e lëndës dhe të pedagogut. Studentëve në këto anketa u jepet mundësia të përshkruajnë vështirësitë, si dhe të japin mendim për çdo përmirësim që duhet t'i bëhet lëndës dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Pas çdo rezultati të siguruar nga anketimi me studentët, në bazë departamenti, bëhet rivlerësimi i brendisë së lëndës nëse konstatohet që diçka e tillë del nga vlerësimet përkatëse.</p> <p>Studentëve u jepet mundësia të ankimojnë në lidhje me rezultatet e vlerësimeve të tyre akademike në çdo rast që ata nuk janë të bindur për vlerësimin e bërë nga përgjegjësi i modulit/ lëndës.<sup>73</sup> Studenti ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e sekretarisë mësimore. Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale nga një komision i cili ngrihet me vendim të departamentit përkatës dhe përbëhet nga tre vetë. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës me shkrim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e ankimeve dhe vlerësimeve i komunikohen çdo pedagogut në zarf të mbyllur. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies.</p> <p>Rezultatet e përgjithshme të anketimeve janë pjesë e raportit vjetor të përgatitur për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilat bëhen publike në fund të çdo viti akademik në faqen kryesore të internetit të institucionit. Njëkohësisht, në mënyrë periodike dhe në përputhje me planin përgatiten raporte të vlerësimit të brendshëm, sipas legjislacionit përkatës. Raportet e vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të KU Bedër<sup>74</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Duke synuar garantimin e cilësisë së mësimdhënies, si dhe kualifikimet e personelit në fushën e kërkimit shkencor, KU Bedër gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të cilat janë mbështetur nga NJSBC-ja dhe zyra e burimeve njerëzore. Ndërkohë, për zhvillimin e këtyre standardeve KU Bedër ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit.<sup>75</sup></p> <p>Institucioni promovon shembujt të praktikave të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnime, leksione të hapuradhe seminare me profesorë të ftuar. Nga ana tjetër, institucioni është përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus+, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, institucioni promovon shembujt të praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë emaili ose faqja e internetit e KU Bedër.</p> <p>Vlerësimi dhe promovimi i praktikave më të mira bëhet nga eporët në raportet vjetore të njësive të ndryshme akademike dhe administrative të</p>

<sup>72</sup>Evidenca nr. 32: Anketa e posaçme e realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19

<sup>73</sup>Evidenca nr. 09: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.

<sup>74</sup>Evidenca nr. 21: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik

<sup>75</sup>Evidenca nr. 77: Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit



	institucionit dhe në takimet me personelin akademik dhe administrativdhe aktivitetet e ndryshme promovuese <sup>76</sup>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi III.2**  
**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit, në përputhje me specifikën e programit të studimit, përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit etj. Departamenti i Drejtësisë në vitin akademik 2019-2020 ka krijuar Klinikën e Ligjit <sup>77</sup> , e cila synon që të ofrojë ndihmë juridike të garantuar nga shteti dhe në të njëjtën kohë të ofrojë praktikën profesionale për studentët nën udhëheqjen e pedagogëve. Për këtë është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit me drejtorinë e ndihmës ligjore falas, pranë Ministrisë së Drejtësisë. <sup>78</sup> Njëkëtë kuadër janë organizuar trajnime me ekspertë të ndryshëm në fushën e drejtësisë.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Kombinimi i formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke pasur parasysh diversitetin e nevojave të studentëve, reflektohet në përditësimin e syllabuseve të lëndëve për çdo vit akademik duke përditësuar dhe format e reja të mësimdhënies dhe kombinimin e tyre, varësisht nevojave të studentëve. Nga ana tjetër, përfaqësues të studentëve janë pjesë e mbledhjeve periodike të këshillit të departamentit, duke sjellë në këto takime zërin e studentëve, propozimet, ankesat apo kërkesat e studentëve në përgjithësi dhe në veçanti edhe për çështje specifike, të cilat merren në shqyrtim nga këshilli i departamentit, duke i reflektuar në përmirësimin e formave dhe përshtatjen e metodave të mësimdhënies me mundësi relative. Gjithashtu personeli akademik i Departamentit të Drejtësisë angazhohet për përmirësimin e njohurive dhe aftësive për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve. Përshtatja dhe përditësimi i syllabuseve kalon nëpërmjet procesit të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie. Mekanizmi i anketimit dhe analizimi i të dhënave të dala janë gjithashtu një mënyrë efektive për të reflektuar nevojat e studentëve.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Në planin strategjik të KU Bedër për periudhën 2018-2023, një nga objektivat strategjikë është sigurimi i një cilësie arsimore që i pajis studentët me aftësi praktike për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës. Për të arritur këtë, synohet që të bashkëpunohet midis departamenteve për ofrimin e lëndëve të cilat sigurojnë kombinimin e përshtatshëm të leksioneve, praktikës mësimore dhe punës praktike, si dhe të bashkëpunohet midis departamenteve për të siguruar leksione të përbashkëta për studentë të interesuar nga të gjitha departamentet dhe disiplinat. Për më tepër, institucioni i kushton rëndësi përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme, si dhe realizon trajnime për personelin akademik në funksion të përmirësimit të metodave didaktike e për t'iu përshtatur objektivave formues, nevojave të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe	KU Bedër synon të tërheqë një staf të kualifikuar, me grada e tituj shkencorë dhe në përputhje me synimet dhe standardet e përcaktuara në Planin Strategjik të institucionit. Në përmbushje të nevojave për një staf akademik me tituj shkencorë e grada shkencore, KU Bedër ndjek politika të punësimit të profesionistëve vendas dhe të huaj me eksperiencë në fushën akademike.

<sup>76</sup>Evidenca nr. 23: Model raporti vjetor i Departamentit të Drejtësisë

<sup>77</sup>Evidenca nr. 37: Vendimi i miratimit të Klinikës Ligjore

<sup>78</sup>Evidenca nr. 38: Marrëveshja e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë



profilit.	Nga CV-të e personelit vërtetohet se anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për t'i plotësuar objektivat e programit. Në përbërje të stafit akademik ka lektorë me formim në fushën e të drejtës ndërkombëtare, të legjislacionit të BE-së, të drejtës penale, penalogjisë, kriminologjisë në universitete si brenda, ashtu dhe jashtë vendit. Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimore, duke iu përshtatur tipologjive të lëndëve dhe mundësive për një mësimnxënie efikase. Për më tepër, personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Siç është përmendur edhe më lart, institucioni ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies edhe studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. Instrumenti që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri. Pyetësori aktivizohet në sistem para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Studentët plotësojnë pyetësorët, ku pyeten për performancën e lektorëve, si dhe metodat apo format që secili lektor aplikon gjatë lëndës së tij. Ky proces është gjithëpërfshirës dhe siguron ruajtjen e anonimatit të studentëve gjatë realizimit të anketimeve. <sup>79</sup> Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të KU Bedër si një kontribut për përmirësime të mëtejshme. Në kuadër të përmirësimit të veprimtarive mësimore dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sugjerojnë workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimit të mbajtura nga pedagogë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. <sup>8081</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Departamenti i drejtësisë përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarat. Studentët marrin pjesë në projekte, dorëzojnë detyra, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura vihet re se Departamenti i Drejtësisë është përpjekur të përfshijë interaktivitetin në mësimdhënie përmes projekteve të ndryshme të realizuara nga studentët, në kuadër të lëndëve të ndryshme, nëpërmjet individëve të ftuar si përfaqësues të agjencive, bizneseve dhe institucioneve publike dhe jopublike. Leksionet e hapura me figura të ndryshme publike, bëjnë të mundur pasurimin e metodave të mësimdhënies. Për të mundësuar realizimin sa më praktik dhe aplikativ të koncepteve dhe konkretizimit të lëndëve, vizitat studimore pranë institucioneve dhe bizneseve të ndryshme dhe organizimi i praktikave profesionale për studentët bëjnë të mundur përfshirjen, aktivizimin e studentëve dhe praktikimin e dijeve të marra gjatë leksioneve
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Në objektivat strategjike të institucionit synohet sigurimi i një arsimit cilësor, i cili si në procesin mësimdhënies ashtu edhe në atë të vlerësimit t'i aftësojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur, si mënyra më efektive për t'i përgatitur për sfidat e së ardhmes. Detyrat dhe projektet janë mënyra më e përdorur që sigurojnë autonomi dhe autodeduksion të studentit. Në praktikimin e punëve në grup dhe projekte, studentët kanë autonomi në organizimin e punëve brenda grupeve dhe në vlerësimin e kontributit të anëtarëve të grupit në punën e përbashkët të tyre, nëpërmjet kriterëve, si përfshirja, kontributi me ide të vlefshme, marrja e iniciativave, gatishmëria dhe realizimi i detyrave, bashkëpunimi dhe ndihma ndaj anëtarëve të grupit. Këto vlerësime përfshihen në vlerësimin e përgjithshëm të studentit për lëndën përkatëse. Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe

<sup>79</sup>Evidenca nr.29: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

<sup>80</sup>Evidenca nr.21:Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik

<sup>81</sup>Evidenca nr.32: Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19



	punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikëqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. Studenti gjithashtu ka mundësi të kontaktojë lektorin në çdo moment me pyetje, komente ose propozime të ndryshme në një nga mënyrat ose platformat e vëna në dispozicion nga institucioni. <sup>828384</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi i mësimdhënies dhe ai shkencor realizohet në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. KU Bedër zhvillon aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira për një periudhë dhjetëvjeçare, me sipërfaqe në total 5628 m <sup>2</sup> . Infrastruktura e përdorur plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 4 të shtojcës nr.3 të udhëzimit të MASH, nr.11, datë 28.02.2011 “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë...”, i ndryshuar, që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të programeve të studimit. Godinat janë të sapo rikonstruara dhe kompani të treta janë kontraktuar për mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre për të gjitha objektet, përfshirë materialet e sistemit elektrik, ngrohjen e të gjitha ambienteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, mirëmbajtjen e mjediseve sportive. <sup>8586</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Godinat kanë një infrastrukturë moderne dhe janë të pajisura me sistem ngrohje. Ato sigurojnë akomodimin e rehatshëm dhe të sigurt të studentëve dhe pedagogëve, duke respektuar të gjitha protokollet e ruajtjes së higjienës dhe sigurisë. <sup>87</sup> Klasat janë të pajisura me kompjutera, vidioprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor, internet në të gjithë godinën për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekën etj. <sup>88</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Personeli dhe studentët shfrytëzojnë sisteme kompjuterike hardwere dhe software, në kuadër të plotësisht të kërkesave të procesit mësimor. Klasat janë të pajisura me kompjutera, linja internet dhe projektorë. Gjithashtu, çdo individ (pedagog, student) është i pajisur me llogarinë e tij të postës elektronike@beder.edu.al me memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom etj. Gjithashtu, me anë të kësaj adrese emaili, studentët aksesojnë llogarinë e tyre personale në sistemin interaktiv Bedër (BIS) të sistemit të brendshëm nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre në KU Bedër <sup>89</sup> . G-Suite me shërbimet e saj është platforma online, e përdorur më tepër për zhvillimin e procesit mësimor dhe komunikimin me studentët gjatë

<sup>82</sup>Evidenca nr.39: Syllabuset e lëndëve të programit

<sup>83</sup>Evidenca nr. 24: Guida e Stafit

<sup>84</sup>Evidenca nr.25: Guida e Studentit

<sup>85</sup>Evidenca nr. 68: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)

<sup>86</sup>Evidenca nr. 80: Kontrata me Albpastrim

<sup>87</sup>Evidenca nr. 81: Rregullorja mbi marrjen e masave higjieno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe Covid-19

<sup>88</sup>Evidenca nr. 68: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)

<sup>89</sup>Evidenca nr. 26:Udhëzues i sistemit informativ (BIS)



	<p>periudhës së pandemisë COVID-19. Gjithashtu, përmes G-Suite çdo pedagog ndan materialet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyra të ndryshme dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>Personeli dhe studentët ka akses në internet në të dyja ndërtesat dhe dy laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me windows: MS Office, Adobe, SAP2000, ETABS, Net Visual Studio C++, Matlab, GNS3 e fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL/ Workbench, Eclipse, Paython (x,y), Rihnocerons 4 SR8 + Vray, 3DMAX dhe SPSS/</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Kolegjit Universitar “Bedër”. Literatura, e cila gjendet në formë fizike dhe elektronike, është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. KU Bedër gjithashtu ka akses në bibliotekën online Jstor<sup>90</sup>.</p> <p>Pedagogu i lëndës zgjedh dhe përditëson literaturën bazë dhe ndihmëse në bazë të nevojës së lëndës dhe silabuseve të përcaktuara. Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekë të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e KU Bedër, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës, nga e hëna në të shtunë, ofron një gamë të gjerë titujsh, rreth 26 000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore. Gjithashtu, biblioteka është e pajtuar në revista shkencore online, si dhe në JSTOR duke u mundësuar studentëve dhe stafit hyrje në këtë bibliotekë botërore. JSTOR mundëson përdorimin e më shumë se 12 milionë artikujve të revistave shkencore në 75 disiplina të ndryshme<sup>91</sup>. KU Bedër disponon një bibliotekë me numër të madh titujsh e botimesh në gjuhë të ndryshme. Biblioteka është e pajisur me tavolina, karrige, kompjuter, wi-Fi dhe ka një ndriçim të lartë natyral<sup>92</sup>.</p> <p>Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU Bedër<sup>93</sup>.</p> <p>KU Bedër ofron nëpërmjet bibliotekës literaturë shumëdisiplinare. Oraret e punës të bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë të bëra publike në hyrje të bibliotekës, mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8:30 deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës.</p> <p>Drejtesit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve, teksteve të bibliotekës për të mbështetur programin, përfshirë buxhetin e planifikuar për të<sup>94</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të bibliotekës, KU Bedër ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike<sup>95</sup>.</p> <p>Lista e të gjithë titujve dhe librave të bibliotekës gjendet online.</p> <p>KU Bedër ka anëtarësim të plotë në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët digjitale e krijuar në 1995, që përfshin më shumë se 2000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga printimi në operacione digjitale, për të zgjeruar aksesin e teksteve shkencore në të gjithë botën, si edhe për t'i ruajtur ato për brezat e ardhshëm<sup>96</sup>.</p>

<sup>90</sup>Evidenca nr. 40: Marrëveshja për akses në JSTOR

<sup>91</sup>Evidenca nr. 40: Marrëveshja për akses në JSTOR

<sup>92</sup>Shtojca 1: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj. (Tabela 17)

<sup>93</sup>Evidenca nr.85: Buxheti i Departamentit të Drejtësisë

<sup>94</sup>Evidenca nr.85: Buxheti i Departamentit të Drejtësisë

<sup>95</sup>Evidenca nr. 18: Udhëzimi mbi funksionimin e bibliotekës

<sup>96</sup>Evidenca nr.40: Marrëveshja për akses në JSTOR



	Çdo anëtar i stafit të KU Bedër mund të hyjë në koleksionet e JSTOR, duke u futur në <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a> ose me anë të llogarisë mail të institucionit <sup>97</sup> .			
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	KU Bedër disponon dy salla laboratorike me kompjutera të kohës, të shfrytëzueshëm nga studentët për realizimin e detyrave, projekteve dhe studimeve specifike gjatë orareve mësimore dhe pas tyre. Në periudhat e sezonit të provimeve sallat laboratorike dhe biblioteka e KU Bedër, të cilat janë të pajisur me kompjutera janë të hapura edhe gjatë fundjavës në dispozicion të studentëve për përgatitjen e tyre. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës.			
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Platforma G-Suite e institucionit ofron shërbime, si: mail, hapësirë pa limit drive, video-konferenca, klasa virtuale, prezantime, teste ose quize on-line, detyra dhe vlerësime për këto. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 kjo platformë siguroi vazhdimësinë e pandërprerë të procesit mësimor akademik në komunikimet e vazhdueshme dhe realizimin e seancave të procesit mësimor. Sistemi i komunikimit të brendshëm elektronik dhe hapësira vetjake e dedikuar mundësohet nëpërmjet sistemit të automatizimit BIS dhe platformës G-Suite si për stafin akademik, administrativ, ashtu edhe për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të regjistruar në institucion. Secili nga studentët, në momentin e regjistrimit pajiset me një adresë emaili në formatin (shkronja e parë e emrit, mbiemri, viti i regjistrimit @beder.edu.al). Stafi akademik dhe administrativ është i pajisur me adresë emailin në formatin (shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al) <sup>98</sup> .			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sistemi i komunikimit të brendshëm elektronik dhe hapësira vetjake e dedikuar mundësohet nëpërmjet sistemit të automatizimit BIS dhe platformës G-Suite si për stafin akademik, administrativ, ashtu edhe për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të regjistruar në institucion. Secili nga studentët në momentin e regjistrimit pajiset me një adresë emaili në formatin (Iniciali i emrit, mbiemri, viti i regjistrimit @beder.edu.al). Stafi akademik dhe administrativ është i pajisur me adresë emailin në formatin (Iniciali i emrit, mbiemri@beder.edu.al) <sup>99</sup> .			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Në fillim të semestrit të dytë, secili student që merr tezën e masterit propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të udhëheqësit, studenti dhe udhëheqësi janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit, duke filluar me zgjedhjen e temës, duke realizuar konsultime të vazhdueshme deri në përfundimin e punimit të tezës. Gjatë kësaj periudhe, studentët marrin prej udhëheqësit të gjithë udhëzimet, mbështetjen, orientimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të saj. <sup>100</sup>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë	Aspekti i përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të

<sup>97</sup>Evidenca nr. 69: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj. (tabela 19)

<sup>98</sup>Evidenca nr. 26: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)

<sup>99</sup>Evidenca nr. 26: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)

<sup>100</sup>Evidenca nr. 82: Syllabus lënda "Teza"





<p>përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi ka krijuar një përvojë të mirë në menazhimin e këtij procesi. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit.<sup>101</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Përveç organizimit në nivel institucioni, sigurimi i cilësisë është i organizuar edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie. Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe vlerësimit të bërë nga titullari i njësisë, personeli akademik ka mundësi të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë.<sup>102103104105106107108</sup> <a href="http://qac.beder.edu.al/">http://qac.beder.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë si njësi bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)- si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve PPT, platformave multimodale, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, aplikimeve studimore, ndërveprimit me të ftuar nga industria që vizitojnë institucionin, praktikave profesionale, vizitave në terren, aktiviteteve vullnetare, projekteve dhe anëtarësimeve në klubet studentore dhe aktiviteteve të tjera jashtë shkollore. Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies është çështje që lidhet si me anën infrastrukturore të institucionit, ashtu edhe me strategjinë e cilësisë së KU Bedër.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Ekzistenca e programeve në fushën e edukimit dhe teknologjisë së informacionit është një mundësi e mirë që shërben për rritjen e shkallës së përvetësimit të metodave inovatore të mësimdhënies nga i gjithë personeli akademik. Bashkëpunimi midis fakulteteve të KU Bedër dhe departamenteve përkatëse ndihmojnë në shkëmbimin e praktikave të mira dhe mbështetjen nëpërmjet seancave të ndryshme të kualifikimit në fushën akademike dhe në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të procesit mësimor.<sup>109</sup> Personeli akademik dhe ndihmës nxitet dhe përfshihet në projekte shkencore rajonale/ndërkombëtare, projekte profesionale vullnetare, seminare/ workshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor.<sup>110</sup> KU Bedër ka ngritur zyrën e kërkimit shkencor, e cila ka rol koordinimin e aktiviteteve me njësitë e tjera, departamentet dhe studentët. KU Bedër stimulon kërkimin shkencor. Ai jep edhe mbështetje financiare për pedagogët e tij për pjesëmarrje në konferenca shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe</p>	<p>KU Bedër nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore përgatit dhe zbaton një plan konkret, në lidhje me trajnimet e domosdoshme për integrimin e personelit në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe asaj kërkimore-shkencore.</p>

<sup>101</sup>Evidenca 08: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë

<sup>102</sup>Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC

<sup>103</sup>Evidenca 10: Shkresa nga NJSBC te HR

<sup>104</sup>Evidenca 11: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve

<sup>105</sup>Evidenca nr. 29: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

<sup>106</sup>Evidenca 32: Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19

<sup>107</sup>Evidenca 21: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik

<sup>108</sup>Evidenca 30: Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit

<sup>109</sup>Evidenca 03: Plani strategjik institucional i KU Bedër 2018-2023

<sup>110</sup>Evidenca nr. 22: Procedura e mbështetjes së pjesëmarrjes në konferenca nga KU Beder




implementimit të metodave të reja.	E rëndësishme në këtë proces është se një pjesë e konsiderueshme e temave përcaktohet nga nevojat e propozuara nga vetë personeli akademik dhe administrativ. Zyra e burimeve njerëzore përmes një emaili zyrtar njofton të gjithë anëtarët e personelit për të propozuar tema, të cilat ata i gjykojnë si të arsyeshme dhe të nevojshme, të cilat ndihmojnë për hartimin e planit të trajnimeve. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të KU Bedër.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në Statutin e KU Bedër, si dhe në Planin Strategjik Institucional, stafi akademik i programit të studimit “Master Shkencor në Drejtësi: profili <i>E drejtë ndërkombëtare</i> dhe Profili <i>E drejtë penale</i> ” dhe stafi mbështetës (koordinatorja e departamentit, zyra e administratorit të fakultetit etj.) janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. <sup>111112113</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	KU Bedër zhvillon aktivitete të ndryshme, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja, analizon efektet e pritshmëritë dhe raporton në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga zyra e burimeve njerëzore. Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. Metodat e ndryshme të mësimdhënies përfshijnë leksione jashtë auditorit nëpërmjet vizitave në ambiente të ndryshme pune, nëpërmjet realizimit të takimeve madje dhe testimave atje ku nesër të diplomuarit e këtij programi do të punojnë. Detyrat dhe projektet bazohen në raste reale konkrete të bizneseve, institucioneve dhe organizatave që janë sot në treg. Studentët i vizitojnë, analizojnë punën e tyre të deritanishme dhe dalin me rekomandime konkrete për përmirësimin e proceseve të tyre. Këto detyra të paraqitura nga studentët vlerësohen jo vetëm nga pedagogu i lëndës, por edhe nga përfaqësuesit e biznesit, institucionit ose organizatës përkatëse, duke sjellë feedback në raport me punën e bërë, i cili reflektohet në vlerësimin e studentëve për këtë detyrë. Angazhimet në grupe pune janë një element shumë i rëndësishëm në procesin e mësimdhënies, i cili ka marrë prioritet në format e trajtimit të projekteve si brenda, ashtu edhe jashtë lëndëve mësimore. Në këto projekte studentët mësojnë të bashkëpunojnë, të tolerojnë, por edhe të kërkojnë llogari, të angazhohen si pjesë e një grupi dhe gjithashtu të vlerësojnë studentët e tjerë për përkushtimin dhe kontributin e tyre. Këto forma analizohen midis pedagogëve dhe studentëve në fund të semestrit për të parë përfitimet dhe nevojat për përmirësim të vazhdueshëm.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Kolegji Universitar “Bedër” angazhon nga tregu i punës ekspertë, të cilët sjellin për studentët në këtë program masteri shkencor përvojën më të mirë në këtë fushë. Një vend të rëndësishëm i kushtohet gjetjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë dhe afrimit të tyre për t’u bërë kontributorë në këtë program, por po ashtu të atyre lektorëve dhe kërkuesve shkencorë që kanë rezultate edhe në punën profesionale të tyre. Përtej nxitjes së studentëve nga këta lektorë e kërkues shkencorë me përvojë profesionale, sërish mbetet një nga prioritetet e Kolegjit Universitar “Bedër” të krijojë hapësira për ndarjen e ideve mbi metodat më të reja të mësimdhënies, por edhe kërkimit shkencor. Kjo realizohet nëpërmjet seminareve, takimeve, tryezave të debatit, trajnimeve online në departamente. Lektorëve që vijnë me përvoja të reja në mësimdhënie nga projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare

<sup>111</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër” i përditësuar

<sup>112</sup>Evidenca nr. 03: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

<sup>113</sup>Evidenca nr. 41: Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore



	u krijohet hapësira për të folur mbi to me qëllim që lektorët e tjerë të përfitojnë. <sup>114</sup>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi III.5**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kolegji Universitar “Bedër” i pajis studentët me Guidën e studentit <sup>115</sup> , e cila informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KU Bedër. Të tilla informacione bëhen të ditura edhe nëpërmjet marrëveshjes që studenti lidh me institucionin. <sup>116</sup> Rregullorja Themelore e KU Bedër, rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit “Master Shkencor” në Drejtësi: profili E drejtë ndërkombëtare dhe profili E drejtë penale”, rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë parashikojnë në mënyrë të qartë modalitetin e vlerësimit dhe përcaktojnë format e ndryshme të vlerësimit që mund të aplikohen nga pedagogët në lëndët e ndryshme. Procesi i vlerësimit përfshin elementët e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësia specifike e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lënda në lëndë.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabusin përkatës të lëndës pedagogu përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat dhe detyrimet që duhen përbushur nga studentët gjatë semestrit së bashku me mënyrën e vlerësimit për këto detyrime. Këto u komunikohen studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu dhe janë gjithashtu të publikuara në sistemin BIS në hapësirën e dedikuar lëndës përkatëse, në të cilën kanë akses studentët dhe pedagogu i lëndës. Syllabuset e lëndëve për të gjitha semestrat kur është dhënë kjo lëndë janë gjithashtu të publikuara në websiten e institucionit në seksionin e programit përkatës law.beder.edu.al <sup>117118</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Pedagogët përdorin forma të ndryshme vlerësimi për t’u dhënë mundësi studentëve që të shprehin dhe të paraqesin njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë lëndës përkatëse. Këto forma përfshijnë: testime gjysmëfinale, projekte, detyra kursi, kuice, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në bashkëpunim me biznese ose agjenci që operojnë në treg, provime finale. Këto forma u japin mundësi studentëve jo vetëm të tregojnë aftësitë e tyre dhe njohuritë e fituara, por edhe të njohin forma të ndryshme të aplikimit të këtyre njohurive dhe aftësive, të zhvillojnë aftësitë e punës në grup, aftësitë e komunikimit me njëri-tjetrin dhe me palët e treta, të zhvillojnë aftësitë prezantuese, analizuese dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës. Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxëniet të lëndës, literaturën e nevojshme dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj. Syllabuset e lëndëve janë të publikuara në Sistemin e Automatizimit BIS. <sup>119120</sup>
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk</b> <b>Përbushet</b> <b>Përbushet</b> <b>Përbushet</b>

<sup>114</sup>Evidenca 45: Lista e aktiviteteve me partnerë të jashtëm

<sup>115</sup>Evidenca 25: Guida e Studentit

<sup>116</sup>Evidenca 46: Model Kontrate

<sup>117</sup>Shtojca 1: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

<sup>118</sup>Evidenca 66: Modeli i syllabuseve

<sup>119</sup>Evidenca 39: Syllabuset e lëndëve

<sup>120</sup>Shtojca 1: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

*(Handwritten signatures)*



	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

**Standardi III.6**  
**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Testimi e vlerësimi i nivelit të suksesit të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Gjatë një semestri janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet; provimet e ndërmjetme- gjysmëfinale (java e 8 e semestrit) dhe provimet përfundimtare- finale (përfundimi i semestrit, java e 15 dhe e 16 e semestrit) <sup>121</sup> . Ndërmjet tyre, studentët testohen me kuice, teste, projekte, detyra, pjesëmarrje në mësim etj. Sipas syllabusit përkatës, vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale; pjesëmarrjes aktive në mësim; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për lëndën në syllabusin e saj. Sipas rregullores së KU Bedër, duhet të ketë të paktën një provim gjysmëfinal dhe një përfundimtar për secilën lëndë në semestër.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	KU Bedër disponon sistemin e brendshëm BIS, ku bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. Gjithashtu, mund të aplikohen teste me forma elektronike, të cilat rrisin transparencën dhe eliminojnë forma të ndryshme abuzimi. Kjo realizohet nëpërmjet formave të testeve në platformën G-Suite.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Një lëndë mund të ketë një titullar dhe një asistent, të cilët bëjnë vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Provimet vlerësohen nga pedagogu/titullari i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, rastet studimore etj., vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mësimor, në disa raste edhe nga një pedagog i ftuar. Prezantimet e punimeve të tezave të studentëve realizohen në prezencë të një komisioni prej tre anëtarësh të stafit akademik, i cili përcaktohet nga këshilli i departamentit. Ky komision, në përbërje të të cilit është edhe pedagogu udhëheqës i studentit, vlerëson punimin dhe prezantimin e paraqitur nga studenti.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Testimi i vlerësimit me shkrim mbikëqyret gjithmonë nga lektorë që nuk janë titullarë të lëndës së testuar dhe janë të paktën dy vëzhgues për sallë. Institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Në rastet e nevojshme, pedagogu është i gatshëm të bëjë sqarimet e nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë. Po ashtu pedagogu mund të shtojë kohën e nevojshme për përvetësimin e njohurive nga ana e studentëve, ose këtë mund ta bëjë me një grup të vogël studentësh.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	KU Bedër nëpërmjet rregullores "Për disiplinën e studentëve" <sup>122</sup> , dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Personeli akademik përgjegjës për punime të ndryshme detyrash dhe tezash, bën kontrollin e dhurave të plagjiaturës me anë të platformave të disponueshme falas dhe me pagesë, përfshirë edhe G-Suite.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas	Kolegji Universitar "Bedër" bën të ditur kalendarin e tij akademik në fillim të çdo viti akademik. Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në

<sup>121</sup>Evidenca 02: Rregullore themelore e Kolegjit Universitar "Bedër", neni 78

<sup>122</sup>Evidenca nr. 78: Rregullorja për disiplinën e studentëve



përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>kalendarin akademik. Ky kalendar pasqyrohet edhe në sistemin e brendshëm BIS, i cili është mënyra zyrtare e afishimit të rezultateve. Staf i akademik është i detyruar të ndjekë kalendarin sipas rregullores së sistemit dhe finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit të automatizimit BIS. Në fund të semestrit pedagogu i lëndës dorëzon dosjen e provimit, e cila është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare, sipas rregullores përkatëse.</p>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Sipas rregullores së programit "Master Shkencor në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale ", në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e sekretarisë mësimore.</p>			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	<p>Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të këshillit të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e studimeve përkatëse, dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit "Master Shkencor" në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë.</p> <p>Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.<sup>123</sup></p> <p>Lëndët e programit të studimit "Master Shkencor" në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale zhvillohen duke u dhënë rëndësinë e duhur teorisë, seminareve, projekteve, rasteve studimore dhe po ashtu praktikave profesionale. Nëpërmjet marrëveshjeve me kompani të ndryshme në vend, KU Bedër u siguron studentëve praktika profesionale cilësore.</p> <p>Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtëkurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore etj.<sup>124,125</sup></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Programi "Master Shkencor" në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale " është i fokusuar në rrishtë bashkëkohore të së drejtës dhe të fushës së shkencave juridike. Ai garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e drejtësisë penale dhe ndërkombëtare, ku një pjesë e literaturës mbështetëse është literaturë e huaj dhe vendime të gjykatave më të rëndësishme ndërkombëtare dhe të BE-së. Staf i është kujdesur që të përditësojë kurrikulat dhe syllabuset, sipas kërkesave të kohës duke përfshirë të rejtat e fushës.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde,	<p>Në përfundim të një semestri, pedagogu i lëndës sigurohet me anë të mjeteve të tij vlerësuese që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe të jenë plotësuar. Kjo paraqitet edhe në anketën e</p>

<sup>123</sup>Evidenca 04: Rregullore e Programit "Master Shkencor në Drejtësi: profili E drejtë ndërkombëtare dhe Profili E drejtë penale "

<sup>124</sup>Evidenca 79: Raporti vjetor Departamenti i Drejtësisë 2018-2019, aktivitetet ekstrakurrikulare

<sup>125</sup>Evidenca 80: Raporti vjetor Departamenti i Drejtësisë 2019-2020, aktivitetet ekstrakurrikulare



analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	vlerësimi që plotësohet nga studentët për lëndët dhe lektorët në mënyrë periodike, çdo vit. <sup>126</sup> Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët ku secila prej palëve paraqet konkluzionet përkatëse për njohuritë dhe shprehitë e fituara, duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Gjithashtu, studentët marrin udhëzime konkrete për format e zbatimit të njohurive dhe të aftësive të fituara, nëpërmjet praktikave profesionale në kompani apo institucione të ndryshme.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+ ose projekteve të tjera. Kolegji Universitar “Bedër” dhe programi “Master Shkencor” në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale u kushton shumë rëndësi leksioneve ose seminareve të hapura për studentët. Në fillim të çdo viti akademik, departamenti harton një plan aktivitetesh, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe leksione, seminare ose workshope të hapura. <sup>127</sup> Të ftuarit në këto orë mund të jenë staf i brendshëm ose i jashtëm. Një praktikë shumë e suksesshme në këtë drejtim kanë qenë seritë e seminareve Brownbag Seminars in Law është një cikël leksionesh të hapura, ku çdo muaj klubi studentor Beder Law Student Association (BLSA) ka një të ftuar, specialist i një fushe specifike në drejtësi.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit “Master Shkencor” në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë dhe në praktikat profesionale. Departamenti ka ndërmjetësuar disa marrëveshje bashkëpunimi midis Kolegjit Universitar “Bedër” me institucione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Krahas ndërmjetësimit, Departamenti i Drejtësisë ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të fushës së drejtësisë, zyra avokatore, Shkollën e Magjistraturës së RSH, institucione dhe organizma ndërkombëtarë që operojnë në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut, si dhe ato penale, me qëllim realizimin e programit. Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunime të tjera në funksion të realizimit sa më mirë të aktivitetit të departamentit. <sup>128</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Diskusimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit “Master Shkencor” në Drejtësi: profili, E drejtë ndërkombëtare dhe profili, E drejtë penale. Personeli akademik organizon diskutime si në lidhje me problematika brenda departamentit, ashtu edhe për çështje të ndryshme sociale apo në lidhje me komunitetin, ku herë pas here janë të ftuar edhe përfaqësues të studentëve, në bazë të tematikave. Zakonisht mbahen mbledhje të tjera periodike për të monitoruar ecurinë e vendimeve të mbledhjeve të mëparshme. <sup>129</sup>
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve	KU Bedër ka ngritur zyrën e kërkimit shkencor, e cila ka rol koordinimi të aktiviteteve me njësitë e tjera, departamentet dhe studentët. KU Bedër

<sup>126</sup>Evidenca 29: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

<sup>127</sup>Evidenca 45: Plani i Aktiviteteve të Departamentit

<sup>128</sup>Evidenca 48: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale

<sup>129</sup>Evidenca 49: Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve



<p>inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>stimulon kërkimin shkencor. Rregullorja mbi kërkimin shkencor<sup>130</sup> përcakton mënyrën e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve kompetente dhe kërkuesve shkencorë, duke përfshirë revistat shkencore, konferencat, projektet kërkimore, publikimet individuale dhe veprimtarinë kërkimore të studentëve, nëpërmjet procedurave që zbatohen në Kolegjin Universitar “Bedër”.<sup>131</sup> Studentët gjithashtu inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. KU Bedër, me anë të Dekanatit të Studentëve u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera. Gjithashtu, organizimi i konferencave studentore është në funksion të promovimit dhe nxitjes së studentëve për të realizuar studime të avancuara kërkimore e shkencore. Për këtë qëllim, në përfundim të vitit akademik, promovohen punimet e studentëve.<sup>132</sup></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, ku mund të përmendim marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Universitetin Aurel Vlaicu Unversita of Arad, Rumani, në kuadër të programit Erasmus+, marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me College of Applied Sciences, “Lavoslav Rurilta” in Vukovar, Kroaci në kuadër të programit Erasmus+ etj Studentët dhe stafi i departamentit të drejtësisë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në programe të ndryshme mobiliteti, të mundësuar nga organizata dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare Studentë të departamentit të drejtësisë kanë aplikuar dhe kanë marrë pjesë në konkurse të simulimit gjyqësor, organizuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shkrimit ligjor dhe aftësisë komunikuese. Konkursi i simulimit gjyqësor të së drejtës ndërkombëtare Filip C. Jessup, i njohur edhe si Jessup është konkursi më i madh dhe më prestigjioz në botë, duke tërhequr pjesëmarrës nga mbi 680 universitete në më shumë se 100 vende në vitet e fundit. Konkursi është një simulim i një mosmarrëveshjeje imagjinare ndërmjet shteteve përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ky konkurs është i organizuar nga Shoqata e Studentëve të së Drejtës Ndërkombëtare dhe zhvillohet në Washington DC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. <a href="https://www.ilsa.org/about-jessup/">https://www.ilsa.org/about-jessup/</a> Konkursi i simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare Penale organizohet nga Qendra Grotius për Studime Ligjore Ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit dhe Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve. Ky konkurs zhvillohet në Hagë, Holandë dhe mirëpret universitete nga e gjithë bota, për një shkallë të madhe të debatit, duke simuluar punimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Konkursi përfshin bashkëpunimin me gjyqtarë nga gjykata ndërkombëtare, profesorë të së drejtës ndërkombëtare (penale) dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Ky rrjet e bën konkursin një simulim real të seancave që zhvillohen në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve. Çështjet e konkursit u drejtohen çështjeve themelore të së Drejtës Penale Ndërkombëtare si procedurale ashtu dhe substanciale. &lt;<a href="http://icmoot.com/">http://icmoot.com/</a>&gt; Konkursi ‘Gjyq simulues i GJEDNJ’ organizuar nga Qendra Europiane në bashkëpunim me Civil Right Defenders (CRD) në Tiranë. Qëllimi i këtij gjyqi simulues është promovimi i standardeve, lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, si një pjesë e pandarë e konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe numrit gjithnjë e në rritje të rasteve të dërguara nga qytetarët</p>

<sup>130</sup>Evidenca 14: Rregullorja mbi kërkimin shkencor

<sup>131</sup>Shtojca 1: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit (Tabela 1)

<sup>132</sup>Shtojca 1: Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit (Tabela 22)



	shqiptarë në GJEDNJ. Studentët përgatiten për një rast hipotetik, duke thelluar në praktikë njohuritë në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre që garantohen nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe njohjen më mirë të jurisprudencës së Gjykatës të Strasburgut. < <a href="http://www.euro-centre.eu/moot-court-gjednj/">http://www.euro-centre.eu/moot-court-gjednj/</a> > Personeli akademik vazhdimisht i nxit dhe i mbështet studentët e programit të marrin pjesë në projekte dhe programe të ndryshme për të përfutur sa më shumë jo vetëm në aspektin akademik dhe praktik, por edhe atë social dhe njerëzor. <sup>133</sup>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Diplomimi është një proces që rregullohet përmes rregulloreve dhe procedurave të miratuara nga institucioni. Ai është pjesë e Rregullores Themelore të institucionit, rregulloreve të studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, rregulloreve të programit, ku saktësohen dhe detyrimet që duhet të përbushë studentit deri në finalizimin e diplomimit të tij <sup>134</sup> . Udhëzimi për shkrimin e tezës është publikuar në faqen e institucionit dhe është i aksesueshëm nga të gjithë studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Udhëheqësit e temës së masterit punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore. Pedagogu udhëheqës i tezës duhet të realizojë së paku 5 seanca konsultimi me studentët, të cilat dokumentohen dhe dorëzohen në departament <sup>135</sup> . Kolegji Universitar “Bedër” bën të mundur bërjen publike të informacioneve rreth provimeve finale ose mbrojtjes së tezave sipas rregulloreve. Udhëheqësit e tezave janë aktori kyç në përcjelljen dhe kontrollimin e këtij informacioni <sup>136</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bëra e një punimi të detyrueshëm të tezës nga ana e studentit, në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, prezantimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i tezës përfshihet si lëndë e semestrit të dytë në programin mësimor.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Udhëheqësi akademik, po ashtu edhe udhëheqësi i diplomës ka rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi. Në fillim të semestrit të dytë, secili student që ka të drejtë të marrë temën e tezës së masterit dhe propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtarit të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron ta kryejë atë. Gjatë kësaj periudhe, studentët marrin prej udhëheqësit të gjitha udhëzimet, mbështetjen, orientimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të punës së tyre kërkimore-shkencore.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së tezës është e udhëheqësit. Është pikërisht udhëheqësi ai që ndihmon studentët edhe për nevoja të veçanta që duhen mundësuar nga institucioni, në kuadër të përgatitjes me sukses së tezës. Udhëheqësi shkencor ka një rol të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së tezës. Në bazë të vlerësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, roli i

<sup>133</sup>Shtojca: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Tabela 20)

<sup>134</sup>Evidenca nr. 09: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

<sup>135</sup>Evidenca nr. 79: Formular i ecursisë së tezës

<sup>136</sup>Evidenca nr. 82: Syllabusi i lëndës së tezës





	udhëheqësit është i mirëpërcaktuar. Laboratorët dhe biblioteka janë në dispozicion. Gjatë periudhës së provimeve dhe punimit të tezës ato janë të hapura edhe në fundjavë.			
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studenti në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës, sipas udhëzuesve të miratuar, asistohet nga udhëheqësi i tezës. Në këtë mënyrë ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Udhëheqësi vendos nëse studentit është gati ta paraqesë punën e tij/saj para një komisioni.			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në fund të tezës studentit vlerësohet me notë, e cila do të shfaqet në transkriptin final të tërheqjes së diplomës. Vlerësimi bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit miratohet nga departamenti. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është udhëheqësi i studentit gjatë përgatitjes së punimit të tezës së masterit <sup>137</sup> .			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, pasi studentit plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 ECTS, nuk ka asnjë notë jokaluese dhe ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara sipas rregullores, atëherë pajiset me diplomë Masteri dhe suplementin e diplomës, sipas formateve të licencuara dhe të aprovuara nga MAS <sup>138</sup> .			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët mund ta aksesojnë programin e zhvilluar në çdo moment, nëpërmjet sistemit të automatizuar BIS. Në përfundim të studimeve, me kërkesë prej tij, studentit pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të studimit të zhvilluar.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Institucioni arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X



<sup>137</sup>Evidenca nr.50: Vendim për ngritjen e jurive të tezave master

<sup>138</sup>Evidenca nr. 09: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

*Skoceli*

*Amj*

*[Signature]*

*[Signature]*

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ.	Zyra e burimeve njerëzore disponon një dosje të posaçme për çdo anëtar të personelit akademik dhe administrativ, të përditësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi <sup>139</sup> . Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Çdo fillim semestri, me propozim të njësisë bazë, aprovim të dekanatit dhe miratim të rektoratit përcaktohet ngarkesa mësimore për secilin anëtar të personelit akademik të çdo departamenti <sup>140</sup> . Shembulli i kësaj procedure mund të vërehet në udhëzimin për ngarkesën mësimore <sup>141</sup> .			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente në rekrutimin e personelit akademik. Kjo procedurë është e parashikuar si në Statutin e KU Bedër <sup>142</sup> , po ashtu edhe në Rregulloren Themelore <sup>143</sup> të institucionit dhe në procedurën e punësimit të personelit <sup>144</sup> . Siç parashikohet edhe në nenin 61 të Statutit, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësisia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, pas pëlqimit të dekanatit dhe miratimit nga rektori. Përzgjedhja e kandidatit kryhet nga një komision <i>ad-hoc</i> , i përbërë me shumicë nga njësisia bazë përkatëse. Komisioni <i>ad-hoc</i> bën renditjen e kandidaturave, ia propozon rektorit dhe ky i fundit bën emërimin me kohë të plotë të punonjësit. Në mënyrë më të detajuar, kriteret dhe procedurat parashikohen në procedurën e punësimit të personelit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	KU Bedër ndjek një politikë efektive për punësimin e personelit akademik të kualifikuar, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Politikat dhe strategjia e punësimit përcaktohen në Statut, në Rregulloren Themelore, por dhe në rregulloren për punësimin e stafit dhe procedurën e punësimit, e cila parashikon hapat e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, gjë kjo qërealizohet përmes një zinxhiri komunikimi formal nga departamenti, në fakultet dhe më pas në rektorat. Sipas kësaj procedure vendet e lira shpallen në web-in e institucionit, në faqet e rrjeteve sociale dhe/ose pranë zyrës së punës, sipas lajmërimit të përgatitur nga zyra e burimeve njerëzore, në përputhje me procedurat e ndjekura për punësimin në vendet e lira.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	KU Bedër ndjek procedurat ligjore dhe transparente në rekrutimin e personelit, në përputhje me statutin dhe rregulloren. Personeli akademik, apo ndihmës mësitor-shkencor, por edhe ai administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të KU Bedër. Stafi në institucion dhe konkretisht në Departamentin e Drejtësisë është përzgjedhur, duke i treguar një rëndësi të veçantë fushës së tyre të specializimit për ta përputhur më së miri me zhvillimin e departamentit dhe të institucionit gjithashtu <sup>145</sup> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>139</sup>Evidenca nr. 51: Lista e të dhënave të dosjes së stafit.

<sup>140</sup>Evidenca nr.59: Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre. (Tabela 7)

<sup>141</sup>Evidenca nr.17: Udhëzim "Për ngarkesën mësimore".

<sup>142</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër", neni 61.

<sup>143</sup>Evidenca nr. 02: Rregullorja Themelore KU Bedër, neni 26.

<sup>144</sup>Evidenca nr.19: Procedura mbi punësimin e personelit akademik.

<sup>145</sup>Evidenca nr. 19: Procedura mbi punësimin e personelit akademik.



Standardi IV.2				
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive				
Kriteret	Vlerësimi			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	KU Bedër disponon mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. KU Bedër ka një sasi të mjaftueshme hapësirash si: laboratorë, klasa, zyra, sallë gjyqi dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve master <sup>146</sup> .			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	KU Bedër, nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore përgatit dhe zbaton një plan konkret në lidhje me trajnimet e domosdoshme për integrimin e personelit. Një shembull i kësaj praktike mund të gjendet në evidencën nr.33 <sup>147</sup> , ku tregohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar plani i trajnimeve të personelit. E rëndësishme është se në këtë proces një pjesë e temave përcaktohet nga vetë personeli akademik dhe administrativ nga interesat dhe nevojat që ata përcaktojnë. Zyra e burimeve njerëzore, nëpërmjet një emaili zyrtar, njofton të gjithë anëtarët e personelit për të propozuar tema që ata i gjykojnë si të arsyeshme dhe të nevojshme, të cilat ndihmojnë për hartimin e planit të trajnimeve <sup>148</sup> .			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	KU Bedër, në fillim të çdo viti akademik, organizon seminare trajnuese për të ndihmuar në përditësimin e stafit akademik me zhvillimet teknologjike në metodat e mësimdhënies. Vlejnë të përmenden edhe trajnimet që janë zhvilluar online vitin e kaluar akademik, të cilat janë përsëritur çdo fillim semestri për shembull, si të përdorim G-Suite gjatë zhvillimit të leksioneve online etj. <sup>149</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Angazhimi i personelit aktual akademik ka synuar dhe ka arritur një punë optimale për përmbushjen e të gjitha objektivave të programeve të ciklit të dytë. Kjo realizohet si në aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione apo kompani të ndryshme, për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. Kjo tregon zbatimin në praktikë të aspekteve teorike të programit, të cilat sigurojnë përvetësim dhe aftësim më të plotë si nga ana e aspekteve teorike ashtu edhe praktike. <sup>150</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve	Sipas nevojave të programeve akademike, KU Bedër ofron mjedise që ndihmojnë studentin në formimin e tij teorik, praktik dhe profesional. Të tilla janë: salla e gjyqit, klinika e ligjit, laborator i gjuhëve të huaja, multimedia lab, laborator i kompjuterave, salla e konferencave, biblioteka etj. Duke iu referuar paraqitjes dhe përshkrimit që na ofron tabela për infrastrukturën, KU Bedër dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme hapësirash, si laboratorë, klasa, zyra apo mjedise të tjera të cilat janë të

<sup>146</sup>Evidenca nr. 68: Mjediset e Fakultetit / Njësie Bazë (Tabela 16)

<sup>147</sup>Evidenca nr. 33: Plani i trajnimeve të personelit.

<sup>148</sup>Evidenca nr. 45: Plani i aktiviteteve të departamentit

<sup>149</sup>Evidenca nr.34: Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2014-2020.

<sup>150</sup>Evidenca nr.41: Vendim i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore; Evidenca nr.56: Ngarkesa tërësisht e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Drejtësi/Profili e Drejta Penale dhe Masteri i Shkencave në Drejtësi/Profili e Drejta Ndërkombëtare. (Tabelat. 4)



përkatese.	pajisura me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve të ciklit të dytë <sup>151</sup> .			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, në përputhje me qëllimet e programit. Auditorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjutera, pulte, internet. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me kondicionim dhe me ndriçim të mjaftueshëm.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programet e ofruara nga KU Bedër nuk janë të gjitha të natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Për të përmbushur nevojat e programeve tona janë ngritur: Klinika e ligjit, salla e gjyqit, salla e konferencave, laborator i informatikës etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Siç e përmendëm më lart, programet e ofruara nga KU Bedër nuk janë të gjitha të natyrës teknike, ndaj Departamenti i Drejtësisë ka në dispozicion Klinikën e Ligjit, sallën e gjyqit etj.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	KU Bedër, veçanërisht Departamenti i Drejtësisë, u kushtojnë rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Institucioni ynë ndër vite ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi (aktive) me institucione dhe organizata të ndryshme të fushës së drejtësisë, si dhe aktorët e biznesit vendas dhe /ose të huaj për praktikën profesionale <sup>152</sup> pranë studiove të ndryshme ligjore apo edhe institucioneve juridiko-administrative në nivel lokal dhe qendror. Ndërkohë, studentëve iu ofrohet mundësia të kryejnë praktikat profesionale <sup>153</sup> edhe brenda institucionit tonë, konkretisht në zyrat administrative përkatese, zyrën e marrëdhënieve me jashtë apo edhe pranë klinikës së ligjit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekën e institucionit të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të librave përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi <sup>154</sup> . Biblioteka është e hapur gjatë gjithë periudhës së aktivitetit universitar, si dhe është e pajisur me vende leximi dhe me kompjuterë duke i ofruar kushte të mira dhe të barabarta për të gjithë studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të	Biblioteka e KU Bedër, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të premte, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 26 000. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU Bedër, duke mbuluar nevojat e

<sup>151</sup>Evidenca nr. 68: Mjediset e Fakultetit / Njërive Bazë (Tabela 16)

<sup>152</sup>Evidenca nr. 23: Model raporti vjetor

<sup>153</sup>Evidenca nr. 23: Model raporti vjetor

<sup>154</sup>Evidenca nr. 18: Udhëzimi mbi funksionimin e bibliotekës.



huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	parashikuara sipas këtyre programeve të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve KU Bedër ka bërë marrëveshje dhe ka akses të plotë si nga ana e studentëve ashtu edhe nga ana e stafit në JSTOR, një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë thjesht duke qenë të lidhur me internetin e KU Bedër <sup>155</sup> .			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e KU Bedër është e pajisur me programe kompjuterike dhe kompjutera për t'ju mundësuar studentëve realizimin e detyrave, si dhe mundësi për të pasur akses online në varësi të nevojave të tyre. Po ashtu, databaza e bibliotekës së KU Bedër gjendet online, duke i ndihmuar studentët në gjetjen e literaturës.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	KU Bedër parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të reja të viteve të fundit në fushën përkatëse <sup>156</sup> . Pasurimi i bibliotekës është bërë gjithashtu edhe përmes një projekti studentor "Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët", përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e nivelit master, në kuadër të së cilës u mbledhën rreth 10 000 libra.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Oraret e bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë bërë publike në hyrje të bibliotekës. Mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8.30 deri në ora 19.00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës. Në funksion të bibliotekës, KU Bedër ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike. Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online JSTOR-një bibliotekë digjitale me punime akademike, libra dhe burime informacioni sipas fushave specifike të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	BIS-i është sistemi i automatizimit që përdoret në KU Bedër. Në faqen e menaxhimit të studentëve jepen informacionet kryesore, në lidhje me studentin: ID, emri, mbiemri, programi, emaili, data e regjistrimit, statusi i regjistrimit të lëndëve, transkripti, statusi i komunikimit me bibliotekën etj. Zyra e burimeve njerëzore bën gjithashtu shpërndarjen e orëve dhe emërimin e pedagogëve. Duhet theksuar se ky proces bëhet përpara hapjes së sistemit të regjistrimit të lëndëve për studentët. Në momentin që është kryer emërimi i pedagogëve dhe është bërë shpërndarja e orëve, atëherë mund të hapet sistemi i regjistrimit të lëndëve <sup>157</sup> .

<sup>155</sup>Evidenca nr. 40: Marrëveshje për akses në JSTOR

<sup>156</sup>Evidenca nr. 44: Buxheti i Departamentit të Drejtësisë

<sup>157</sup>Evidenca nr. 26: Udhëzuesi i sistemit informativ.(BIS)



<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Sipas këtij sistemi të gjitha njësitet kanë një llogari, faqen e tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Në BIS ka një llogari për secilën nga njësitet e mëposhtme: Llogari për studentët, për stafin akademik, burimet njerëzore, sekretarinë e studentëve, bibliotekën, koordinatoret e departamenteve, financën, menaxhimin e dokumenteve, zyrën e pranimit, zyrën e programit të shkëmbimit etj. Nga ana tjetër i gjithë dokumentacioni që lidhet me procesin e mësimdhënies, dorëzohen pranë sekretarive të departamenteve.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Sipas këtij sistemi, të gjitha njësitet kanë një llogari, faqen e tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Ky sistem, ofrohet me llogari për studentët dhe me llogari për personelin akademik dhe administrativ. Nëpërmjet sistemit u sigurohet akses në të dhëna dhe informacione. Po ashtu një pjesë e informacioneve dhe dokumenteve mund të merren pranë sekretarive<sup>158, 159</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>KU Bedërka realizuar integrimin në sistemin e menaxhimit të institucionit BIS të platformës Google për arsim. Kjo platformë mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit dhe studentëve. Për këtë përdoruesit (personeli dhe studentët) janë të pajisur me një postë elektronike në domainin beder.edu.al që është një llogari në Google. Gjithashtu institucioni përdor platformën “G-Suite” për të aksesuar, koordinuar dhe organizuar materialet mësimore të lëndëve në Cloud. Sistemi BIS e mundëson komunikimin midis studentëve dhe personelit ku si shembull mund të përmendet komunikimi për procedurat mbi llogarinë e financës. Pasi studenti paraqet mandatin e pagesës pranë zyrës së financës, financa aprovon në sistem mandatin e pagesës nëpërmjet aprovimit të studentëve për të regjistruar lëndët në fillim të semestrit<sup>160</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi Informativ Bedër (BIS) është një sistem që e lehtëson punën në institucionin KU Bedër. I kryen veprimet në një rrugë të automatizuar duke shmangur kështu gabimet e mundshme duke ndjekur të gjitha rregullat dhe procedurat që dalin nga senati ose rektorati. Sistemi BIS u jep mundësinë si studentëve, ashtu edhe lektorëve të monitorojnë në kohë reale pjesëmarrjen në mësim, notën, të dhënat e studentit etj.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Në faqen zyrtare në internet të institucionit beder.edu.al gjenden informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera të Kolegjit Universitar “Bedër” që publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë: njëra është gjuha shqipe dhe tjetra në gjuhën angleze. Në këtë faqe publikohen edhe informacione të dedikuara njësive kryesore e atyre bazë. Informacionet që lidhen me Departamentin e Drejtësisë gjenden në adresën law.beder.edu.al</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.6**  
**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë</p>	<p>Çdo vit fondacioni harton një raport ku parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit. Në raport paraqiten shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të gjitha të detajuara sipas llojit. KU Bedër gëzon statusin e institucionit të lartë jofitimprurës. Një mbështetje e madhe për institucionin janë donacionet. Institucioni siguron</p>

<sup>158</sup>Evidenca nr.25: Guida e Studentit  
<sup>159</sup>Evidenca nr.24: Guida e Stafit  
<sup>160</sup>Evidenca nr.69: Të dhëna të plota për platformën on-line. Struktura e teknologjisë së informacionit biblioteka/ biblioteka online etj., (Tabela 17)

studimi.	që të ketë të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. <sup>161</sup>			
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grandet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Në raportin financiar të institucionit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Brenda raportit janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte. Në raport paraqiten të gjitha shpenzimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesit në bibliotekat on-line, detyrimet financiare etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të grandeve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Çdo vit fondacioni harton një raport të situatës financiare nga një kontabilist i miratuar dhe ky raport ruhet pranë fondacionit. Raportet financiare hartohen sipas legjislacionit në fuqi nga fondacioni, pjesë e të cilit është KU Bedër, brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. KU Bedër i paraqet çdo fund viti akademik Ministrisë së Arsimit dhe Sportit raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik, si dhe projektbuxheti afatmesëm.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU Bedër bëhet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”, në ligjin nr.8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	KU Bedër gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Duke vlerësuar veprimtarinë e deri më sot, KU Bedër dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe bashkë me mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<sup>161</sup>Evidenca nr.70: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18).



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përpunimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga KU Bedër bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Po ashtu, KU Bedër, me qëllim realizimin e një procesi mësimor sa më rezultativ, i kushton një rëndësi të veçantë raportit numerik personell akademik/student, i cili siguron një edukim cilësor dhe realizimin e objektivave të institucionit. Komunikimi i brendshëm në KU Bedër kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. <sup>162</sup> <sup>163</sup> <sup>164</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejtën e njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, për vitin akademik 2020-2021, janë si më poshtë: 1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70%. 2. Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%. Kjo garanton barazinë në përzgjedhjen e kandidatëve për student në programet që KU Bedër ofron. Gjithashtu, KU Bedër ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, KU Bedër ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj. <sup>165</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përpunimit përkatës kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	KU Bedër, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve që ofron. Sa më sipër, njësiti bazë kanë faqet e tyre të internetit, të cilat mund të aksesohen si në mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe përmes faqeve të njësive kryesore, siç janë faqet e fakulteteve. Në këto faqe ka një paketë të gjerë transparence, në lidhje me programet e studimit që ofrohen, përfshirë këtu personelin akademik, kurrikulat, syllabuset e lëndëve, këshillat e departamenteve etj. Po ashtu, procedurat, përzgjedhjet e studentëve dhe njoftime që lidhen me procesin e regjistrimit apo të transferimit të studimeve, bëhen në faqen zyrtare dhe në platforma që administrohen nga KU Bedër. <sup>166</sup> Këto informacione mund të sigurohen edhe përmes sekretarive të departamentit dhe sekretarisë mësimore ose pranë zyrës së pranimit. <sup>167</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit. Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KU Bedër mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes panairëve të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KU Bedër.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e	KU Bedër është një institucion që ka kriteret në pranimin e studentëve. Varësisht politikave institucionale si një institucion jofitimprurës, KU Bedër ka pranuar një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore që zotëron. Përmes kësaj politike, KU

<sup>162</sup>Evidenca 09: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

<sup>163</sup>Evidenca 02: Rregullore themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”

<sup>164</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, neni 3.

<sup>165</sup>Evidenca 09: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

<sup>166</sup>Evidenca 12: Rregullorja e transferimeve

<sup>167</sup>Shembull njoftimi <https://ëëë.beder.edu.al/sh/ncës/other/lista-e-kandidateve-fitues-te-raundit-te-pare-viti-akademik-2020-2021/1591>





përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Bedër ka synuar angazhimin maksimal të personelit akademik ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim. Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairove të arsimit dhe karrierës etj., KU Bedër bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron, tarifën e studimit dhe kriteret e pranimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme edhe për publikun me anë ta faqes së internetit, konkretisht me guidën e studentit. <sup>168</sup> Këto informacione mund të merren nga studentët edhe pranë sekretarisë së departamentit apo pranë sekretarisë mësimore. Po ashtu, mund të merren edhe nëpërmjet këshilltarit akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët informohen nëpërmjet guidës së studentit dhe duke marrë informacion paraprak te zyra e sekretarisë mësimore dhe në departament. Në përputhje me këtë, studentët të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit, pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur jo më pak se dy semestra studime pranë KU Bedër. <sup>169170</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në çdo syllabus i cili është publik në faqen e departamentit, gjenden edhe kriteret apo zërat e vlerësimit, gjë e cila u bëhet e ditur studentëve që në javën e parë të prezantimit të lëndës. Po ashtu, edhe në sistemin BIS, këto zëra vlerësimi ofrohen në kohë reale. <sup>171</sup> Më tej, po në sistemin BIS, gjendet ecuria dhe vazhdimësia, jo vetëm e një lënde e gjithë periudhës së studimeve, nota dhe pikët e secilës lëndë; notat dhe pikët e grumbulluara, pjesëmarrja në leksione dhe seminare, si edhe mesatarja e gjeneruar nga sistemi. <sup>172173</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në programin e studimit, studentët kanë të përfshirë një lëndë të posaçme dedikuar kërkimit shkencor dhe shkrimit akademik, e cila është lëndë e detyrueshme. Po ashtu, studentët kanë një udhëheqës përgjatë punimit të diplomës, me të cilin kryejnë në mënyrë të detyrueshme seanca konsultimi rreth punimit të diplomës. <sup>174</sup> Kriteret dhe procedurat e punimit dhe vlerësimit të diplomës janë të sqaruara në rregulloren e programit, rregulloren e ciklit të dytë të cilat iu bëhen të qarta studentëve që në javën e orientimit. KU Bedër organizon herë pas here seanca trajnimesh për kërkimin shkencor, duke iu ardhur në ndihmë studentëve në një mënyrë ekstrakurrikulare.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Siç është thënë edhe më sipër, KU Bedër mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes panairove të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KU Bedër. Nga ana tjetër, KU Bedër publikon katalogë përmes faqes zyrtare së internetit, shpërndan broshura, organizon takimeve të drejtpërdrejta, dhe është pjesë e panairove etj.

<sup>168</sup>Evidenca 25: Guida e Studentit

<sup>169</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>170</sup>Evidenca 12: Rregullorja e transferimeve

<sup>171</sup>Evidenca nr. 66: Modeli I syllabueseve, elementet sipas VKM 41/2018, (Tabela 14)

<sup>172</sup>Evidenca nr. 67: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

<sup>173</sup>Evidenca 25: Guida e Studentit

<sup>174</sup>Evidenca nr. 79: Formular i ecurisë së tezës



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	KU Bedër në javën e parë të fillimit të viti akademik sheh me rëndësi të veçantë “Ditët e orientimit”. Përgjatë këtyre ditëve studentët njihen me stafin akademik dhe me atë administrative, orarin, sistemin BIS, strukturën e KU Bedër, kohëzgjatjen dhe organizimin e programit. Po ashtu, institucioni nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të këshillimit ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet në nenin 6 të rregullores për studimet e ciklit të parë dhe provimeve. <sup>175</sup> Këto informacione dhe shumë të tjera publikohen si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faqja zyrtare e KU Bedër. <sup>176</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Siç u përmend edhe më sipër, informacioni ofrohet si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faqja zyrtare e KU Bedër. Në faqe gjendet guida e studentit, e cila prezantohet edhe në “Ditët e orientimit”, struktura dhe ngarkesa e programit të studimit, modulet dhe lëndët. Nga ana tjetër, nëpërmjet sistemit BIS studentët informohen për gjëra më specifike, lëndët përkatëse, informacione që mund të merren edhe pranë sekretarisë. <sup>177178</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU Bedër ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë dekanatit të studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Këshilltari i karrierës informon studentët me email mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët e diplomuar, organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj. <sup>179180181</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në ditët e orientimit, secila zyrë realizon prezantimin e saj dhe informon studentët mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit.

<sup>175</sup>Evidenca 09: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

<sup>176</sup>Linku i ndërfaqes së Programit “Bachelor” dhe “Master” në “Drejtësi”: <https://lae.beder.edu.al/>


<sup>177</sup>Evidenca nr. 25: Guida e Studentit

<sup>178</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, neni 3.

<sup>179</sup>Evidenca 80: Raporti vjetor I Departamentit të Drejtësisë, viti akademik 2019-2020.

<sup>180</sup>Evidenca 80: Raporti vjetor I Departamentit të Drejtësisë, viti akademik 2019-2020.

<sup>181</sup>Evidenca nr.87: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës



<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KU Bedër përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm.</p> <p>Studentët e regjistruar në KU Bedër informohen në kohë reale kudo që ndodhen përmes sistemit BIS (Beder Information System), ku në ekranin e gjithsecilit shfaqet njoftimi përkatës. Ky komunikim mund të bëhet edhe nga distanca. Vetë sistemi BIS është i lidhur me Gmail në domainin @beder.edu.al, duke krijuar kështu një komunikim më efektiv. Komunikimi i brendshëm në KU Bedër kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al.<sup>182</sup></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit realizohet në dy mënyra atë hard copy i cili menaxhohet nga sekretaria mësimore dhe departamentet për aq sa i përket pjesës së tyre, si dhe nëpërmjet platformës dixhitale BIS (Beder information system) e cila menaxhon dhe përpunon të dhënat e studentëve në mënyrë dixhitale. Studentët dhe stafi kanë llogarinë e tyre me anë të së cilës shohin të gjitha informacionet që u përkasin profileve të tyre.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e sekretarisë mësimore pranë KU Bedër ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve, duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre dhe raporton në mënyrë periodike në fund të çdo semestri statistikat e studentëve të çdo programi. Nga ana tjetër, zyra e sekretarisë mësimore, ndër funksionet e saj ka edhe përpunimin e të dhënave në formë statistikore të të diplomuarve. Kjo parashikohet në rregulloren e zyrës së sekretarisë mësimore, neni 3.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Zyra e sekretarisë mësimore pranë KU Bedër disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve dhe i raporton këto statistika te instancat përkatëse.</p> <p>Institucioni siguron informacion në kohë reale përmes sistemit BIS, si dhe nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore.<sup>183184</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të gjitha rezultatet e vlerësimit të studentëve në çdo lëndë nëpërmjet sekretarisë së departamentit i kalojnë zyrës së sekretarisë mësimore, e cila i arkivon ato.</p> <p>Këshilltari akademik – në llogarinë e tij në sistemin BIS ka informacione të detajuara, në lidhje me mbarëvajtjen akademike për secilin nga studentët që ai këshillon. Këto të dhëna përfshijnë rezultatet e studentëve për të gjitha lëndët që studenti ka frekuentuar gjatë viteve</p>

<sup>182</sup>Evidenca nr. 25: Guida e Studentit

<sup>183</sup>Evidenca 80. Raporti vjetor i Departamentit të Drejtësisë, viti akademik 2019-2020.

<sup>184</sup>Evidenca nr.73: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)



	<p>të tij të eksperiencës akademike që nga pranimi në KU Bedër e deri në diplomim.<sup>185</sup></p> <p>Këto të dhëna disponohen edhe nga sekretaria mësimore. Çdo notë e studentëve regjistrohet në kopje fizike dhe kopje elektronike në sistem duke gjeneruar informacion të qartë mbi ecurinë e studentëve dhe performancën e tyre. Për secilin student sistemi llogarit mesataren semestrale dhe mesataren kumulative, e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi rezultatet pozitive dhe negative të studentëve. Këto informacione të hollësishme ndihmojnë në vendime të ndryshme që lidhen me nevojën e përsëritjes së lëndëve me qëllim përmirësimi të notës, si dhe me diplomimin e studentëve.</p> <p>Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti lidhur me studentët.</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Siç u përmend më sipër, zyra e sekretarisë mësimore pranë KU Bedër ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve, duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre. Kjo zyrë kryen analiza dhe nxjerr të gjitha të dhënat statistikore. Këto të dhëna gjenerohen nga sistemi BIS, i cili aksesohet nga këshilltari akademik dhe sekretaria mësimore.<sup>186</sup></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p>Departamenti harton raporte vjetore periodike, ku reflektohet e gjithë ecuria e studentëve që nga regjistrimi deri në punësim. Të dhënat e përfshira në raportet vjetore të njësive bazë shërbejnë si bazë për hartimin e raportit vjetor institucional, i cili dorëzohet në MAS. Në fund të çdo raporti bëhet edhe analiza SWOT, me qëllim përmirësimin e aspekteve që nevojiten.<sup>187</sup></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, studentët janë të përfshirë në senat, NJSBC, komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë.</p> <p>KU Bedër me vendim senati gjithashtu ka vendosur që studentët të jenë të përfshirë në këshillin e departamentit dhe këshillin e fakultetit.<sup>188</sup></p> <p>Për të garantuar përfshirjen dhe përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse në KU Bedër është ngritur Dekanati i Studentëve, i cili është është përgjegjës për marrëdhëniet e studentëve me institucionin. Dekanati i Studentëve është përgjegjës për përdorimin sa më me efikasitet të burimeve të institucionit dhe për menaxhimin e marrëdhënies të sipërpërmendura, në përputhje me parimin "Studenti nëqendërtë universitetit". Dekanati i Studentëve i kryen detyrat e tij në bashkëpunim me rektorin ose zëvendësrektorin. Kjo instancë i kushton rëndësi të veçantë kujdesit ndaj studentëve, duke pasur si mision kryesor orientimin, këshillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve nga zyrat përkatëse.</p> <p>Një rol të veçantë në këtë aspekt, luan edhe presidenti i këshillit studentor. Mbështetja nga Dekanati i Studentëve fillon që nga momenti i aplikimit të studentit dhe vazhdon edhe pas diplomimit, duke ruajtur një në marrëdhënie produktive dhe mbështetëse si për studentin, ashtu edhe për institucionin.</p>

<sup>185</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, neni 3.

<sup>186</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>187</sup>Evidenca 23: Raporti vjetor i Departamentit

<sup>188</sup>Evidenca 49: Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë të pranishëm përfaqësues të studentëve



	Gjithashtu, Dekanati i Studentëve organizon dhe mbështet studentët në praktikat profesionale, aktivitete sociale, projekte të ndryshme, si dhe në gjetjen e mundësive të ndryshme të punësimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KU Bedër ka një rregullore të posaçme për vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohet sipas rregullores mbi anketat dhe vlerësimet, e cila përfshin vlerësimet e studentëve për personelin, vetëvlerësimin e personelit, vlerësimin e eprorëve për vartësit etj. Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies. Anketimet me studentët zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri. <sup>189</sup> <sup>190</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Vlerësimi sasior i punës së studentëve në KU Bedër kryhet me anë të krediteve sipas sistemit amerikan dhe atij evropian të mbështetur në ECTS, kurse vlerësimi cilësor i punës së studentëve kryhet me anë të notave, të llogaritura sipas metodologjisë së përmendur në rregulloret mësimore. Përsa i përket ngarkesës, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një programi master me kohë të plotë është 60. Kjo vërtetohet edhe nga programet e licencuara nga MAS dhe të shprehura në kurrikulën e programit, si edhe në Statutin e KU Bedër. KU Bedër lejon transferimin e studentëve në vitet ndërmjetëse nga IAL-të vendase ose të huaja, publike ose private, dhe anasjellas, si edhe brenda programeve të studimeve që ai ofron. Ky proces bëhet pas një barasvlerësimi sipas planeve mësimore përkatës. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh. <sup>191</sup> <sup>192</sup> KU Bedër ofron mundësi për transferime të studimeve midis programeve të të gjitha cikleve brenda KU Bedër apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin. Mënyra e transferimit në programet e ofruara në KU Bedër parashikohet në rregulloret mësimore të KU Bedër
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Në faqen e çdo departamenti, janë të publikuara të gjitha syllabuset e viteve të kaluara, gjë e cila është e aksesueshme nga publiku, si dhe nga studentët. Në këtë kuptim, ata mund ta krahasojnë syllabusin aktual me atë të viteve të kaluara dhe të konsultojnë atë me studentët përgjatë diskutimit dhe prezantimi të lëndës. Studentët janë të përfshirë në grupet e punës për riorganizimin dhe/ose hapjen e programeve akademike. KU Bedër i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve të ndryshme vetëvlerësuese, qofshin këto në lidhje me aspektin administrativ të institucionit, po aq edhe me aspektin akademik. Çdo fundviti, njësitë bazë dhe kryesore përgatisin raportin vjetor të cilin e dërgojnë në rektorat. Në këto raporte, përveç pasqyrimit të aktiviteteve, rëndësi i kushtohet edhe analizës SWOT.
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e njësisë përgjegjëse. E drejta e ankimimit është parashikuar në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë dhe u ofron të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë mundësinë e ankimimit. Sa më sipër, shërbejnë edhe anketimet e studentëve për personelin akademik, të cilat plotësohen përmes sistemit online të informimit (Beder Information System - BIS), para zhvillimit të provimeve

<sup>189</sup>Evidenca nr. 29: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

<sup>190</sup>Evidenca 49: Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve

<sup>191</sup>Evidenca nr. 09: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të dytë

<sup>192</sup>Evidenca nr. 65: Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit për secilin program (Tabela 13)

	<p>finale në çdo fund semestri. Plotësimi i pyetësorëve është anonim dhe përgjigjet përpunohen në mënyrë automatike dhe të pavarur.<sup>193</sup></p> <p>Pas sigurimit të të dhënave vlerësuese për personelin akademik, në fund të çdo semestri akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të personelit akademik, rezultati i të cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur.<sup>194</sup></p> <p>Gjithashtu, vlen të theksohet që krahas pikave të sipërpërmendura, studentët mund të parashtrajnë kërkesa dhe të bëjnë ankime edhe pranë sekretarisë së departamentit.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	KUB është një institucion i arsimit të lartë, i orientuar drejt kërkimit shkencor duke inkurajuar të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e stafit akademik vlerësohen në bazë të kriterëve të përcaktuara në udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, si dhe rregulloren mbi projektet kërkimore-shkencore. KUB ofron gjithashtu, mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari. <sup>195</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Që nga fillimi i veprimtarisë së KUB, një ndër objektivat e tij ka qenë promovimi ndërkombëtar, si dhe vendosja e marrëdhënieve të ngushta me institucionet e arsimit të lartë në rajon dhe më gjerë. Për të realizuar këtë qëllim, në vitin 2011 u themelua zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare. KUB ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. KUB ndjek një politikë favorizuese me institucionet e huaja arsimore, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për personelin akademik dhe studentët, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikant studentore. Aktualisht institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione, mes të cilave universitete, bashki, institucione publike dhe private.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e ciklit të dytë, studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime. Rezultati është botimi i artikujve dhe pjesëmarrja në konferenca të ndryshme, si dhe organizimi në mënyrë të përvitshme i Konferencës Ndërkombëtare të Studiuesve të Rinj. Siç parashikohet edhe në ligjin për arsimin e lartë, por edhe në rregulloret e brendshme institucionale, departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Departamenti mbështetet financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur nga institucioni dhe përgjigjet për financimin e grupeve kërkimore. Departamenti, bazuar në rezultatet e punës së grupeve kërkimore, sugjeron vazhdimësinë ose ndërprerjen e bashkëpunimit me to. <sup>196</sup> Në fund të çdo viti akademik bëhet vlerësimi i rendimentit të ekipit akademik, bazuar në reagimin e marrë në vlerësimin e punës shkencore në bazë të treguesve transparentë të botuar në rregulloret përkatëse.

<sup>193</sup>Evidenca nr. 29: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.

<sup>194</sup>Evidenca nr. 29: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.

<sup>195</sup>Procedura e mbështetjes së pjesëmarrjes në konferenca nga KU Bedër

<sup>196</sup>Evidenca nr. 14: Rregullorja mbi Projektet Kërkimore-Shkencore

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Në përputhje me rregulloret e brendshme të KUB, çdo grup studentësh ka të përcaktuar nga departamenti këshilltarin akademik i cili u ofron këshillim studentëve, i ndihmon dhe ndjek ecurinë e tyre. Gjithashtu, studentëve nëpërmjet zyrës së planifikimit të karrierës që operon pranë drejtorisë së marrëdhënieve me studentët, u ofrohet shërbimi i këshillimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Në fillim të semestrit të dytë, secili student që merr tezën e masterit propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtarit të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të udhëheqësit, studenti dhe udhëheqësi janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit, duke filluar me zgjedhjen e temës, duke realizuar konsultime të vazhdueshme deri në përfundimin e punimit të tezës. Gjatë kësaj periudhe, studentët marrin prej udhëheqësit të gjitha udhëzimet, mbështetjen, orientimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të saj.<sup>197</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.7</b></p>	
<p><b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>KUB ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Në organizimet e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, KUB ka mbështetur pjesëmarrjen e studiuesve të rinj, veçanërisht të doktorantëve. Në kuadër të marrëdhënieve që ka ndërtuar me MAS, KUB zbaton politikat shkencore rajonale dhe kombëtare, duke i konkretizuar me aktivitete të realizuara dhe të tjera që planifikohen të mbahen në vijim. Gjithashtu, institucioni punon ngushtë me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë drejtim KUB ka nënshkruar kartën për studiuesit Europiane, në përputhje me orientimin e AKTI. Personeli akademik është trajnuar nga AKTI në drejtim të zbatimit të projekteve dhe të programit Horizont 2020.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Programi ka pjesë të kurrikulës së tij lëndën e metodave të kërkimit, të cilat e orientojnë studentin të fitojë pavarësi dhe lirshmëri në realizimin e projekteve kërkimore- shkencore në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, kurrikula është hartuar duke u mbështetur në kuadrin ligjor i cili përcakton standardet karakterizuese të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat karakterizojnë profilin e programit të studimit, si dhe u siguron studentëve vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Kërkimi shkencor parashikuar dhe në planin strategjik të KU “Bedër” është një ndër elementet e rëndësishme për funksionimin e aktivitetit institucional përkrah mësimdhënies dhe kontributit në shoqëri. Në këtë aspekt, rëndësi merr kërkimi shkencor, mbështetja e inovacionit, cilësia e edukimit, si dhe pranimi i studentëve cilësorë. Kërkimi shkencor ka qenë në fokus të procesit akademik në KU “Bedër”, ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. KUB aplikon në mënyrë të vazhdueshme në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, në përgjigje të thirrjeve për aplikime në projekte hulumtuese-shkencore në fushën e shkencave humane, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit. Në aplikime, një rëndësi e veçantë i kushtohet përfshirjes së studiuesve të rinj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë</p>	<p>KU “Bedër” ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj</p>

<sup>197</sup>Evidenca nr. 39: Syllabuset e lëndëve të programit



integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	dhe për këtë arsye ka punësuar gjatë viteve pedagogë të huaj nga disa shtete të ndryshme të botës, si: SHBA, Anglia, Gjermania, Turqia, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. KU “Bedër” me anë të udhëzimit për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen arritjet akademike vjetore për indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Kolegji Univeristar Bedër dhe departamenti i Drejtësisë në veçanti ndjekin një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. Studentët e angazhuar në veprimtari ndërkombëtare si Jessup Moot Court, ICC moot court, trajnime dhe workshope ndërkombëtare etj., kanë një përparësi për shkak të përgatitjes së tyre në përballjen me sfidat ndërkombëtare të studimit.			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Për realizimin e objektivave të programeve të studimeve, institucioni dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj. Me institucionet arsimore të huaja që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndjek një politikë favorizuese për personelin akademik dhe të studentëve të huaj, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale e praktika studentore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	KU Bedër dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si njësi e saj kryesore, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve “Master” që ofron. Pra, informacionet bazë studentët i marrin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar. Po kështu edhe zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe u ofrojnë atyre të gjitha shërbimet e kërkuara. Kështu zyra e regjistrimit, këshilltari akademik, dekani i studentëve, sekretaria mësimore, zyra e planifikimit të karrierës së studentëve të diplomuar etj. janë në funksion të informimit e ofrimit të shërbimeve për studentët Gjithashtu, studentët pajisen me syllabusin përkatës nga çdo lektor në fillim të semestrit. Studentët gjatë gjithë periudhës janë në kontakt të vazhdueshëm me këshilltarin akademik. Po ashtu, janë vazhdimisht të informuar rreth performancës së tyre akademike nëpërmjet sistemit të informimit të brendshëm BIS dhe emaileve që marrin nga zyrat e përmendura më lart. <sup>198</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ky sistem funksionon nëpërmjet këshilltarit akademik dhe këshilltarit të karrierës së ngritur pranë njësi bazë. Nëpërmjet tyre, studentët informohen, këshillohen, asistohen për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për çështje që lidhen me praktikën apo me programe ekstrakurrikulare <sup>199200</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve	Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU Bedër

<sup>198</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>199</sup>Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare.

<sup>200</sup>Evidenca 42: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike

64










<p>shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë dekanatit të studentëve. Pranë kësaj zyre, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar.<sup>201</sup> Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësi punësimipër të gjithë studentët e diplomuar në programet “Master”, organizon aktivitete që synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj. Një rol i rëndësishëm i kësaj zyre është mundësimi i praktikave profesionale për studentët e të gjithë departamenteve që ofron KU Bedër.<sup>202203</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e karrierës dhe zyra e të diplomuarve përgatisin raporte periodike, në lidhje me punësimin e studentëve, trajnimin e tyre, dhe mundësive që ofron tregu, dhe ua paraqesin ato studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. KU Bedër, në strukturën organizative ka ngritur zyrën e të diplomuarave, e cila funksionon në varësi të Dekanatit të Studentëve. Kjo zyrë mban të dhëna në lidhje mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve dhe i vë këto të dhëna në dispozicion të studentëve,organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>






<sup>201</sup>Evidenca nr. 83: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës

<sup>202</sup>Evidenca 23: Raporti vjetor i Departamentit të Drejtësisë

<sup>203</sup>Evidenca 23: Raporti vjetor i Departamentit të Drejtësisë



65

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” synon të ofrojë mësimdhënie cilësore për studentët, në përputhje me të gjitha parashikimet ligjore në fuqi. Kështu, për të garantuar cilësi institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) kryetar, 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i këshillit studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm.<sup>204</sup> Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Po ashtu, institucioni ka ngritur dy komisione të përhershme të cilat janë të parashikuara në Statut. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tyre është përcaktuar me rregullore të veçanta.<sup>205206</sup> Komisionet janë Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit dhe Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin. Këto komisione vlerësojnë periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit. Në të dyja këto struktura krahas anëtarëve të tjerë janë të përfshirë edhe përfaqësues të këshillit studentor, i cili zgjidhet nga studentët dhe një ekspert i jashtëm.<sup>207</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>KU “Bedër” ka kaluar me sukses tre procese akreditimi institucional, në vitin 2013 nga APAAL, në vitin 2017 nga agjencia britanike e akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL, si dhe së fundmi nga ASCAL.<sup>208</sup> Gjithashtu, programet e studimit kanë kaluar në proceset e akreditimit dhe të vlerësimit të jashtëm. Krahas këtyre, në vlerësimet periodike institucionale përfshihen edhe ekspertët e jashtëm të cilët japin mendimin e tyre rreth ecurisë që ka ndjekur institucioni për garantimin e cilësisë. Në kuadër të vlerësimeve të jashtme, institucioni ka lidhur marrëveshje me organizata ndërkombëtare si “Educators Without Borders” me qendër në Gjenevë.<sup>209</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>KU “Bedër” i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve vetëvlerësuese, me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Në funksion të kësaj, qëndrojnë disa hallka që bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me njëra-tjetrën. Së pari, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka si kompetencë hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë. Këto akte ia dërgon Senatit Akademik, i cili po ashtu është një aktor i rëndësishëm në vlerësimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Krahas këtyre, funksionojnë dy komisionet e përhershme. Aktorë shumë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të programeve të studimit janë edhe departamentet të cilët në përfundim të çdo viti</p>

<sup>204</sup>Evidenca nr. 10: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-së

<sup>205</sup>Evidenca nr. 07: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin

<sup>206</sup>Evidenca nr. 08: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit

<sup>207</sup>Evidenca nr. 76: Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)

<sup>208</sup><https://www.beder.edu.al/sh/ncës/top/beder-riakreditohet-me-5-vite-te-tjera-20/1711>

<sup>209</sup>Evidenca nr. 84: Memorandum Bashkëpunimi me organizatën “Educators Without Borders”

	<p>akademik përgatisin raporte ku përfshijnë analizën SWOT.</p> <p>Në mbështetje të politikave për përmirësimin e programeve të studimit, KU “Bedër” është bërë pjesë e një projekti shumë të rëndësishëm “Bologna Hub Peer Support” nën koordinimin e DAAD -German Academic Exchange Service dhe Ministrisë Gjermane të Arsimit dhe Kërkimit, në bashkëpunim me Erasmus+.KU “Bedër” ka aplikuar për këshillim dhe mbështetje në tri çështje kryesore për përmirësimin e programeve të studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërkombëtarizimi: mobiliteti, projektet dhe kërkimi shkencor;</li> <li>2. Zhvillimi i kurrikulës: ECTS dhe përfshirja e qasjeve inovative në mësimdhënie dhe të nxënit, motivimi i stafit dhe studentëve për përdorimin e tyre;</li> <li>3. Sigurimi i cilësisë: Implementimi, zhvillimi i një kulture të cilësisë në institucion.</li> </ol> <p>Ky projekt është në vazhdim dhe ka rezultuar efektiv në rritjen e cilësisë në institucion.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>Institucioni ka ngritur zyrën e koordinimit të programeve master me qëllim monitorimin dhe mbikëqyrjen e programeve të ciklit të dytë.</p> <p>Gjithashtu, njësitë bazë në fillim të çdo viti akademik zgjedhin Komitetin Shkencor për çdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbehet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti Shkencor mban përgjegjësinë organizative për programin përkatës të ciklit të dytë.<sup>210</sup></p> <p>Përveç kësaj, çdo program i ciklit të dytë ka një koordinator të veçantë, të zgjedhur nga Komiteti Shkencor i cili ndjek mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>Zhvillimi i kurrikulës së programeve të studimit bëhet sipas një procedure të miratuar nga Senati Akademik.<sup>211</sup> Sipas kësaj procedure, zhvillimi i kurrikulës kryhet nën autoritetin e Senatit Akademik, përmes njësive kryesore (fakulteti) dhe njësive bazë (departamenti). Njësitë bazë që dëshirojnë të krijojnë, ndryshojnë apo të mbyllin ndonjë program, duhet të konsultohen fillimisht me zyrën e zhvillimit të kurrikulës. Ata duhet të kërkojnë mendimin e një eksperti të jashtëm për të garantuar cilësi dhe paanshmëri në bërjen e ndryshimeve. Njësia kryesore merr parasysh dhe shqyrton propozimet e paraqitura nga njësia bazë dhe vendos dërgimin për miratim ose jo në senat akademik.</p> <p>Senati akademik miraton propozimet e paraqitura nga njësia kryesore, nëse e vlerëson të arsyeshme, dhe lajmëron njësinë bazë për rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Iniciativat për ndryshimet mund të vijnë për shkaqe të ndryshme, ku një ndër to mund të jenë edhe anketat e plotësuara nga studentët.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	<p>Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore.<sup>212</sup></p> <p>KU “Bedër” vlerëson ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit përmes proceseve të mëposhtme të anketimit dhe të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Plotësimi i formularit të vetëvlerësimit nga stafi akademik;</li> <li>● Anketë vlerësimi e stafit akademik ndaj institucionit;</li> <li>● Anketë vlerësimi e stafit administrative ndaj institucionit;</li> </ul>


<sup>210</sup>Evidenca nr. 09: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

<sup>211</sup>Evidenca nr. 15: Udhëzimi mbi procesin e zhvillimit të kurrikulës

<sup>212</sup>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër

67





	<ul style="list-style-type: none"> <li>Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit;</li> <li>Anketë vlerësimi e studentëve ndaj stafit akademik.</li> </ul> <p>Gjithashtu, një tjetër proces vetëvlerësimi është auditimi i brendshëm i bërë nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori. Ky komision auditon njësitë akademike dhe administrative mbi ligjshmërinë e administrimit të dokumentacionit të brendshëm.</p>								
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e vlerësimeve arkivohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përkatëse që janë përgjegjëse për vendimmarrje, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 13 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. <sup>213</sup> Lidhur me auditimin, në rast mospërputhshmërie me dispozitat staturore apo me rregulloret, komisioni ad-hoc u ngarkon detyrat përkatëse njësite për t'i plotësuar ato sipas kuadrit ligjor në fuqi.								
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm shoqërohen me planveprime ku parashikohen rezultatet e vlerësimit dhe përcaktohen masat që do të merren për adresimin e mangësive dhe për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Në planveprim gjithashtu caktohen njësitë përgjegjëse për ndjekje dhe periudha kohore e zbatimit të planveprimit. KU "Bedër" publikon rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit në faqen e internetit. Lidhur me rezultatet e pritshme, institucioni harton plane strategjike, së fundmi planin strategjik institucional për periudhën 2018-2023, ku një rëndësi e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. <sup>214</sup>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Përveç vlerësimeve të përmendura më lart, njësia më e përfshirë në vlerësimin e programit të studimit është njësia bazë, pra departamenti. Në çdo mbledhje trajtohet mbarëvajtja e procesit mësimor. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik, i gjithë stafi mblidhet dhe diskuton mbi veprimtarinë e departamentit, duke kontribuar edhe në përgatitjen e raportit vjetor. Sa i përket programeve të ciklit të dytë, departamenti që në fillim të vitit cakton Komitetin Shkencor i cili përbëhet nga tre anëtarë dhe është përgjegjës për vlerësimin e programit të studimit. Në çdo rast, kur pas diskutimeve në departament apo në Komitetin Shkencor, lind nevoja për përmirësim të kurrikulës, departamenti inicion procedurën duke u bazuar në udhëzimin mbi procesin e zhvillimit të kurrikulave. <sup>215</sup> Në procedurën e ndryshimit të kurrikulave, përfshihen edhe ekspertë të jashtëm, studentët, madje edhe të diplomuarit me qëllim që të adresohen në mënyrë të saktë të gjitha problematikat me të cilat mund të jetë përballur një program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Një nga metodat e vlerësimit të veprimtarisë së njësite është organizimi i prezantimeve të raportit vjetor në prani të të gjithë stafit akademik ku shkëmbehen përvojat dhe jepen sugjerime dhe rekomandime për përmirësimin e çështjeve të caktuara. Nisur nga këto analiza vjetore, në fillim të çdo viti akademik hartohet plani vjetor nga çdo njësi. Njësitë bazë gjithashtu organizojnë takime këshillimi me profesionistë të fushës, si dhe me të diplomuar për t'u informuar më tepër mbi dinamikat e tregut të punës në mënyrë që këto dinamika të pasqyrohen në program.

<sup>213</sup>Evidenca nr. 10: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-së

<sup>214</sup>Evidenca nr. 03: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

<sup>215</sup>Evidenca nr. 15: Udhëzimi mbi procesin e zhvillimit të kurrikulës



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>KU “Bedër”, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies,<sup>216</sup> vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,<sup>217</sup> testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi.          Studentët përfshihen në mbledhje departamenti dhe kontribuojnë me mendimet e tyre në vendimmarrje. Gjithashtu, për të diplomuarit organizohen aktivitete të ndryshme ku zhvillohen takime me stafin akademik apo me studentët aktuale, ku shkëmbehen përvojat dhe jepen rekomandime mbi programet e studimit.          Gjithashtu, prej vitesh njësia bazë konsultohet edhe me bashkëpunëtorët e jashtëm, duke përfshirë edhe lektorët me kohë të pjesshme të cilët po ashtu kontribuojnë me sugjerime mbi zbatimin e programit të studimit.<sup>218</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

**Standardi VI.4**  
**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KU “Bedër” garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm.          Stafi i KU “Bedër” është kolektivisht përgjegjës për ruajtjen e standardeve akademike. NJSBC ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.<sup>219</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, stafin akademik dhe administrativ, studentët dhe palë të tjera, të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit janë të përcaktuara nga institucioni në rregulloret përkatëse.          Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe</p>	<p>Në analizat vjetore mbi mbarëvajtjen e institucionit, marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit, duke përfshirë stafin akademik dhe administrativ. Ata shkëmbejnë përvojat e tyre dhe japin rekomandime në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.          KU “Bedër” synon informimin në çdo kohë të stafit dhe të studentëve mbi cilësinë e programeve të studimit. Për këtë arsye, vazhdimisht organizohen</p>

<sup>216</sup>Evidenca nr. 31: Formulari i vetëvlerësimit të stafit

<sup>217</sup>Evidenca nr. 20: Procedura mbipraktikën profesionale

<sup>218</sup>Evidenca nr. 48: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.

<sup>219</sup>Evidenca nr. 10: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-së

studentët e programit të studimit.	takime informuese dhe trajnime. Atyre u është vënë në dispozicion Guida e Stafit <sup>220</sup> dhe Guida e Studentit <sup>221</sup> ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. KU Bedër siguron përfshirjen e personelit akademik, administrativ dhe të studentëve në proceset e vlerësimit të cilësisë s programit të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja e aktorëve të brendshëm bëhet gjithmonë duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazi. KU "Bedër" është i përkushtuar të krijojë një mjedis edukimi dhe pune, duke përjashtuar çdo lloj diskriminimi. Kjo zbatohet për të gjithë personelin dhe studentët. <sup>222</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Siç u përmend edhe më lart, njësitë bazë organizojnë takime këshillimi me profesionistë të fushës për t'u informuar më tepër mbi dinamikat e tregut të punës në mënyrë që këto dinamika të pasqyrohen në program. Në procesin e hartimit të programeve të studimit janë përfshirë edhe ekspertë të jashtëm me qëllim pasurimin e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Një nga metodat e rëndësishme për të përmirësuar punët në njësitë kryesore është organizimi i prezantimeve të raportit vjetor në prani të të gjithë stafit akademik, ku shkëmbehen përvojat dhe jepen sugjerime dhe rekomandime për përmirësimin e çështjeve të caktuara. Strategjia e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU "Bedër". Institucioni ka miratuar planin strategjik 2018-2023 ku kanë marrë pjesë përfaqësues të rektoratit, të departamenteve, njësive kryesore, si dhe përfaqësues të studentëve të diplomuar dhe të këshillit, për të siguruar një përfaqësim sa më të plotë e gjithëpërfshirës. Plani strategjik është i aksesueshëm për këdo në faqen zyrtare të institucionit. <sup>223</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimeve të brendshme të programeve të studimit i vihen në dispozicion personelit akademik, ndërsa raportet e akreditimeve të programeve dhe vlerësimet e jashtme publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë, duke respektuar etikën akademike dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga konstatimet e vlerësimeve dhe pas diskutimit të tyre edhe në njësitë bazë përkatëse në NJSBC, në komisionet e përhershme dhe në Senatit Akademik, ngrihen grupe pune për hartimin e planveprimeve. Një shembull është planveprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor i cili u finalizua me miratimin e disa akteve të rëndësishme nga Senati Akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Informacionet e marra nga pyetësorët e ndryshëm janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë njësitë kryesore respektive. Raportet për monitorimin e cilësisë shpërndahen te stafi akademik dhe diskutohen për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit. Varësisht rezultateve të vlerësimeve periodike të formave të ndryshme të vetëvlerësimit, bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim ose zhvillim të mëtejshëm, varësisht zyrave përkatëse dhe më pas riauditohet nga komisioni ad-hoc.

<sup>220</sup>Evidenca nr. 24: Guida e Stafit

<sup>221</sup>Evidenca nr. 25: Guida e Studentit

<sup>222</sup>Evidenca nr. 24: Guida e Stafit, fq.12

<sup>223</sup>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, faqa eeb: qac.edu.al



	Vlejnë për t'u përmendur këtu monitorimi i zbatimit të planveprimeve të hartuara në kuadër të rekomandimeve të dala nga vlerësimet e jashtme apo nga akreditimi i programeve të studimit, si dhe rishikimi i dokumentacionit me qëllim përmirësimin e cilësisë në vijim të auditimit të brendshëm që zhvillohet në institucion.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	KU "Bedër" synon informimin në çdo kohë të stafit dhe të studentëve mbi cilësinë e programeve të studimit. Për këtë arsye, vazhdimisht organizohen takime informuese, trajnime, si dhe u vihet në dispozicion Guida e Stafit <sup>224</sup> dhe Guida e Studentit <sup>225</sup> ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, me qëllim informimin sa më të plotë të studentëve me programin që ndjekin, kurrikulën, personelin dhe infrastrukturën në dispozicion të tyre, caktohet një këshilltar akademik për studentët e ciklit të parë dhe koordinatori i programit për studentët e ciklit të dytë për çdo vit akademik. <sup>226227</sup> Institucioni informon studentët për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu, institucioni siguron përfshirjen në proceset e akreditimeve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<sup>224</sup>Evidenca nr. 24: Guida e Stafit

<sup>225</sup>Evidenca nr. 25: Guida e Studentit

<sup>226</sup>Evidenca nr. 42: Vendim i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademikë

<sup>227</sup>Evidenca nr. 43: Vendim i këshillit të departamentit për caktimin e koordinatorit të programit



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signatures]*

**D. PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË  
CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË "DREJTËSI" NË  
PROFILET: A. E DREJTË PENALE; B. E DREJTË NDËRKOMBËTARE TË  
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË "KOLEGJI UNIVERSITAR  
BEDËR"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Përvetësimi i koncepteve bazë juridike në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare, si dhe përdorimi i tyre me efikasitet;
2. Integrimi i teorikës, praktikës dhe politikave të ndryshme, në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të ligjit penal dhe ndërkombëtar;
3. Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijes dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme në mënyrë që të jenë të aftë për t'u përshtatur me tregun e punës;
4. Njohja me institutet e së drejtës penale në Shqipëri dhe në Europë, si dhe dallimet që kanë sistemet e ndryshme penale ligjore;
5. Familjarizimi i studentëve me përgjegjësinë etike dhe profesionale;
6. Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin;
7. Zhvillim i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit, duke përfshirë këtu si organet shtetërore, ashtu edhe departamentete tjera juridike në vend;
8. Përcjellja e trendëve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare;
9. Përgatitja e kuadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë;
10. Përgatitja e kuadrove në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe europiane;
11. Dhënia e kontributit në zhvillimin e sistemit juridik penal dhe ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë;

**Pika të dobëta**

1. Mangësia e hapësirës shqiptare me tekste cilësore dhe bashkëkohore akademike në gjuhën shqipe;
2. Numri i madh i universiteteve publike dhe private që kanë departamente të drejtësisë kufizon mundësinë e përzgjedhjes së studentëve;
3. Inflacioni i dhënies së diplomave në fushën e drejtësisë ul interesin e studentëve për të zgjedhur degën e drejtësisë;
4. Paqartësia e kuadrit ligjor lidhur me programin e drejtësisë;
5. Mungesa e kampusit.





[www.beder.edu.al](http://www.beder.edu.al)



Rr. "Jordan Misja", Tiranë